



Kompania Rajonale e Ujësjetjesit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

KRU. "GJAKOVA" SH.A. Gjakovë			
Marrë në datën: 06.03.2019			
Njësia org.	Numri	Shtojca	Vlera
	765		

KOMPANIA RAJONALE E UJËRAVE "GJAKOVA" SH.A. GJAKOVË



PLANI AFATGJATË I INVESTIMEVE 2019 – 2028

Shkurt, 2019



Kompania Rajonale e Ujësjetësimit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

KRU "GJAKOVA" SH.A. Gjakovë			
Marrë në datën: 06-07-2019			
Ndërsa prej:	Numri:	Shtesa:	Vlera:
	765		

KOMPANIA RAJONALE E UJËRAVE "GJAKOVA" SH.A. GJAKOVË



PLANI AFATGJATË I INVESTIMEVE 2019 – 2028

Shkurt, 2019

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	8
1. HYRJE	12
1.1 QËLLIMI I PLANIT	12
1.2 OBJEKTIVAT E PLANIT	12
1.3 ZONA E SHËRBIMIT	12
1.4. KAPACITETET E PRODHIMIT TË UJIT	14
1.5. ASPEKTET ADMINISTRATIVE DHE INSTITUCIONALE	14
1.6 AKTIVITETET E PLANIFIKUARA TË KOMPANISË.....	14
1.7 STRUKTURA E PLANIT AFATGJATË TË INVESTIMEVE (PAI).....	15
2. DOKUMENTET E SHFRYTËZUARA	16
2.1 PLANI I BIZNESIT 2018-2020.....	16
2.2. PLANI I MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE	16
2.3 PLANI I MENAXHIMIT TË THATËSISË	16
2.4 STRATEGJIA E ZVOGËLIMIT TË HUMBJEVE TË UJIT	17
2.5 STUDIMI I FIZIBILITETIT PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË KANALIZIMIT	17
2.6 PROJEKSIONET DEMOGRAFIKE – SHTIMI I POPULLSISË	18
2.3 PLANIFIKIMI URBAN.....	20
2.3.1 <i>Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+</i>	<i>20</i>
2.3.2 <i>Plani Zhvillimor i Komunës së Gjakovës 2006–2015+</i>	<i>20</i>
2.3.3 <i>Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit: 2010–2020+</i>	<i>21</i>
3. METODOLOGJIA	24
3.1 TË DHËNAT E PËRGJITHSHME	24
3.2 INFORMACIONET E SHFRYTËZUARA	24
3.2.1 <i>Plani i Biznesit 2018-2020.....</i>	<i>24</i>
3.2.2 <i>Planet zhvillimore.....</i>	<i>24</i>
3.3 VLERËSIMI I KËRKESËS PËR UJË	25
3.4 OBJEKTIVAT E KOMPANISË	25
3.5 PLANI I MENAXHIMIT TË ASETVE.....	25
3.6. DEKLARATA E NIVELIT TË SHËRBIMIT PËR KRU "GJAKOVA" SH.A.....	26
4. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMIT	30
4.1 INFRASTRUKTURA EKZISTUESE E FURNIZIMIT ME UJË	30
4.1.1 <i>Komuna e Gjakovës.....</i>	<i>30</i>
4.1.2 <i>Komuna e Rahovecit.....</i>	<i>33</i>
4.1.3 <i>Komuna e Prizrenit (fshatrat).....</i>	<i>35</i>
4.2 INFRASTRUKTURA EKZISTUESE E KANALIZIMIT.....	39
4.3 TRAJTIMI I UJËRAVE TË NDOTURA.....	39
5. ANALIZA E KËRKESËS PËR UJË	41

5.1	BILANCI I KËRKESËS DHE KAPACITETEVE TË FURNIZIMIT	41
5.1.1	<i>Shtimi i popullsisë</i>	41
5.1.2	<i>Kërkesa për ujë</i>	41
5.1.3	<i>Kapaciteti i furnizimit</i>	45
5.1.4	<i>Bilanci i kërkesës dhe furnizimit</i>	45
6.	INVESTIMET E PLANIFIKUARA	47
6.1	INVESTIMET E PLANIFIKUARA ME PLANIN E BIZNESIT 2019-2021.....	47
6.2	INVESTIMET NË SISTEMIN E FURNIZIMIT ME UJË	49
6.2.1	<i>Shtimi i kapaciteteve të furnizimit</i>	49
6.2.2	<i>Zgjerimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë</i>	49
6.3	INVESTIMET NË SISTEMIN E KANALIZIMIT	50
6.3.1	<i>Investimet në zgjerimin e rrjetit të kanalizimit</i>	50
6.3.2	<i>Investimet në rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit</i>	50
6.3.3	<i>Investimet në trajtimin e ujërave të ndotura</i>	51
7.	DINAMIKA E PLANIFIKUAR E INVESTIMEVE	53
7.1	SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJË.....	53
7.1.1	<i>Shtimi i kapaciteteve të furnizimit dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit</i>	53
7.2	SISTEMI I KANALIZIMIT	58
8.	BURIMET E FINANCIMIT	60
8.1	INVESTIMET NGA TË HYRAT E KOMPANISË	60
8.2	INVESTIMET QË PRITET TË FINANCOHEN NGA BURIMET E JASHTME.....	63
8.3	PËRMBLEDHJE	66
SHTOJCAT		68
	SHTOJCA 2: INVESTIMET E PLANIFIKUARA ME PLANIN E BIZNESIT 2019-2021.....	70
	SHTOJCA 3.0: KËRKESA PËR UJË NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KOMPANISË	79
	SHTOJCA 3.2: KAPACITETET E FURNIZIMIT ME UJË TË KOMPANISË.....	84
	SHTOJCA 3.3: BILANCI I FURNIZIMIT ME UJË	85
	SHTOJCA 4: INFRASTRUKTURA EKZISTUESE E FURNIZIMIT ME UJË	87
	SHTOJCA 5: VENDIMI I BORDIT DHE VENDIMI PËR KOMISIONIN PËR HARTIMIN E PAI 2019-2028	89

Lista e figurave

Figura 1: Zona e shërbimit të KRU Gjakova	12
Figura 2: Grafiku i parashikimeve të popullsisë së Kosovës	19
Figura 3: Grafiku i parashikimit të shtimit të popullsisë	19
Figura 4: Liqeni i Radoniqit	34
Figura 5: Foto nga Impiantet e trajtimit të ujit të pijes 1 dhe 2	35
Figura 6: Sistemi i gypsjiellësve kryesor të KRU Gjakova.....	42
Figura 7: Rrjeti ekzistues i kanalizimit në Gjakovë.....	44
Figura 8: Grafiku i bilancit të kërkesës dhe kapacitetit të furnizimit me ujë	51
Figura 9: Lokacioni i paraparë për ndërtimin e ITUN në Gjakovë.....	57
Figura 10: Pamja dizajnuese e ITUN Gjakovë	58
Figura 11: Grafiku i dinamikës së investimeve.....	63
Figura 12: Grafiku i dinamikës së planifikuar të investimeve në sistemin e kanalizimit.	65
Figura 13: Investimet e Kompanisë të miratuara me procesin tarifar 2018-2020	66
Figura 14: Grafiku i dinamikës së Investimeve nga burimet e jashtme dhe KRU Gjakova.....	70

Lista e tabelave

Tabela 1: Kapacitetet e prodhimit të KRU Gjakova	13
Tabela 2: Popullsia e Kosovës sipas grup moshave dhe viteve (varianti i mesëm)	17
Tabela 3: Të dhënat e popullsisë për komunat e zonës së shërbimit të KRU Gjakova	18
Tabela 4: Parashikimi i Zhvillimit Urban të Gjakovës	20
Tabela 5: Përshkrimi i Deklaratës së Nivelit të Shërbimit.....	25
Tabela 6: Burimet e ujit dhe kapacitetet e shfrytëzimit në komunën e Gjakovës	30
Tabela 7: Rezervuarët dhe pakaciteti i furnizimit në Komunën e Gjakovës	30
Tabela 8: Stacionet e pompimit të sistemit të furnizimit me ujë të Gjakovës	31
Tabela 9: Burimet e ujit dhe kapacitetet e shfrytëzimit në komunën e Rahovecit	32
Tabela 10: Rezervuarët dhe pakaciteti i furnizimit në Komunën e Rahovecit	32
Tabela 11: Stacionet e pompimit – Komuna Rahovec.....	33
Tabela 12: Rezervuarët dhe pakaciteti i furnizimit në Komunën e Prizrenit	33
Tabela 13: Stacionet e pompimit në Komunën e Prizrenit	34

Tabela 14: Pasqyrë e gypsjiellësve kryesorë të sistemit të furnizimit me ujë në KRU Gjakova.....	39
Tabela 15:Përmbledhje e investimeve të planifikuara në rrjetin e kanalizimit në komunën e Gjakovës	38
Tabela 16: Parashikimi i shtimit të popullsisë	41
Tabela 17: Kërkesa e përgjithshme për ujë për periudhën planifikuese	412
Tabela 18: Kapacitetet e furnizimit të KRU Gjakova.....	444
Tabela 19: Bilanci i kërkesës dhe kapacitetit të furnizimit për komunat e zones së shëbimit	45
Tabela 20: Përmbledhje e investimeve të planifikuara me Planin e Biznesit 2019-2021	46
Tabela 21: Përmbledhje e investimeve në sistemin e furnizimit me ujë 2019-2028	53
Tabela 22: Dinamika kohore e investimeve të planifikuara në sistemin e ujesjellsit	55
Tabela 23: Dinamika e planifikuar e investimeve në kanalizim	58
Tabela 24: Investimet e Kompanisë të miratuara me procesin tarifor 2018-2020	610
Tabela 25: Dinamika e investimeve të planifikuara nga të hyrat e Kompanisë	61
Tabela 26: Dinamika e investimeve që pritet të financohen nga burimet e jashtme	63
Tabela 27: Përmbledhje e investimeve të planifikuara	66

Shkurtesat

AC	Asbest-çimento
ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DMA	Zonë e matur (ang. 'district metered area')
DN	Diametri nominal
EUR	Euro
FPU	Fabrika e përpunimit të ujit
ITUN	Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura
ITUP	Impianti i trajtimit të ujit të pijshëm
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
km	Kilometër
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetjes
L	Gjatësia
m	Metër
mm	Milimetër
p.e.	Popullsi ekuivalente
PAI	Plani Afatgjatë i Investimeve
PB	Plani i Biznesit
PE	Polietilen
PVC	Polivinil klorid
RWSSP	Programi për Mbështetje të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimit në Zonat Rurale (ang. 'Rural Water and Sanitation Support Programme')
SCADA	Sistemi për monitorim dhe automatizim të procesve (ang. "supervisory control and data acquisition")

Përmbledhje Ekzekutive

Qëllimi i Planit

Plani Afatgjatë i Investimeve (PAI) i KRU Gjakova përfshin periudhën 10-vjeçare: 2019-2028.

Qëllimi kryesor i këtij Plani është që të planifikojë investimet në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit bazuar në kërkesat që vijnë si rezultat i:

- (i) projeksioneve demografike dhe zhvillimore në zonën e shërbimit,
- (ii) kërkesave rregullatore për nivelin e shërbimeve, dhe
- (iii) faktorëve tjerë si, ndryshimet klimatike, vjetërsia e infrastrukturës etj.

Aktivitetet e Planifikuara të Kompanisë

Kompania është e përkushtuar për ndërmarrjen e të gjitha aktiviteteve investive dhe operative me qëllim të krijimit të një infrastrukture të konsoliduar të ujësjellësit dhe kanalizimit në interes të ofrimit të shërbimeve cilësore për konsumatorët e vet jo vetëm sot por edhe në të ardhmen. Në këtë kontekst, Kompania është e përcaktuar që brenda periudhës së ardhshme 10-vjeçare t'i shtojë kapacitetet e veta në mënyrë që t'i shtrijë shërbimet në tërë territorin e 3 komunave që janë në kuadër të zonës së shërbimit të Kompanisë. Gjithashtu, brenda periudhës së ardhshme 10-vjeçare, me mbështetjen e donatorëve dhe Qeverisë, Kompania ka filluar të ndërtojë impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura për qytetin e Gjakovës si dhe në bashkëpunim me komunat përkatëse ta zgjerojë rrjetin e kanalizimit në fshatrat e komunave të cilat aktualisht nuk kanë rrjet të kanalizimit dhe ujërave.

Metodologjia

Për hartimin e këtij Plani, janë marrë parasysh, për aq sa është e mundur, të gjithë faktorët që kanë të bëjnë me shtimin e popullsisë, zhvillimin dhe planifikimin urban, resurset ekzistuese ujore, parashikimi i kërkesave për ujë, analizat hidraulike, gjendjen e infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe kanalizimit, investimet e parashikuara dhe burimet e mundshme të investimeve. Duhet theksuar se me rastin e hartimit të PAI nuk janë bërë analiza ekonomike meqenëse natyra e këtij plani është e atillë që i njëjti përqendrohet në identifikimin e nevojave, ndërkaq analizat ekonomike për komponente të veçanta të këtij plani do të bëhen me rastin e planifikimeve të detajuara në kuadër të proceseve tarifore para se të realizohen të njëjtat.

Objektivat e Kompanisë për periudhën e ardhshme 10-vjeçare të cilat kanë ndikim në PAI janë:

1. Furnizimi me ujë të mjaftueshëm në pajtim me standardet e cilësisë për të gjithë konsumatorët 24 orë në ditë.
2. Zvogëlimi i humbjeve të ujit në nivelin 36% (aktualisht 44%).
3. Rritja e mbulueshmërisë me shërbime të furnizimit me ujë në shkallën 100% (aktualisht 92%).
4. Rritja e arkëtimit në shkallën 96% (aktualisht 94%).

5. Rritja e mbulueshmërisë me shërbimet e kanalizimit në shkallën 85% (aktualisht 55%);
6. Trajtimi i ujërave të ndotura të kanalizimit në komunën Gjakovës;
7. Shfrytëzimi racional i burimeve të ujit;

Bilanci i kërkesës për ujë dhe kapacitetit të furnizimit

Shtimi i parashikuar i popullsisë për komunat e zonës së shërbimit të KRU Gjakova është kalkuluar duke marrë për bazë trendin e njëjtë të rritjes të parashikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për Kosovë. Bazuar në këtë kalkulim, është vlerësuar se gjatë periudhës 10 vjeçare (deri në vitin 2028) popullsia në zonën e shërbimit të Kompanisë do të ketë një shtim relativisht të vogël prej rreth 3.000 banorë në total krahasuar me popullsinë aktuale.

Kërkesa për ujë gjatë periudhës planifikuese nuk pritet të rritet si rezultat i saisë së mjaftueshme që në këtë moment .Shkalla e mbulueshmërisë në këtë moment është 92% së mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit ecila pritet që pas tri viteve ntë arrijë në 100%.

Për përlllogaritjen e kërkesës për ujë janë bërë supozimet si vijon:

- 1) *Është parashikuar ngritja e shkallës së mbulimit me shërbime të ujësjellësit prej 100%;*
- 2) *Është parashikuar zvogëlimi i shkallës së ujit të pafaturuar (UPF) prej 44% sa është aktualisht në 36% për vitin 2028;*
- 3) *Është parashikuar rritja graduale e normës së konsumit të ujit nga 115 litra/ditë/banor (sa faturohet aktualisht) në 130 litra/ditë/banor në vitin 2028. Kjo rritje e normës së konsumit pritet të ndodhë si rezultat i zvogëlimit të humbjeve komerciale të ujit (vjedhja e ujit, pasaktësitë e matjes dhe faturimit etj.).*

Bilanci uJOR është kalkuluar duke bazuar në kërkesën e planifikuar për ujë në njërën anë, dhe kapacitetet aktuale të furnizimit në anën tjetër, e duke pasur parasysh rritjen e planifikuar të mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit. Në bazë të këtyre kalkulimeve është konkluduar se, në nivel të zonës së shërbimit të Kompanisë, e gjithë zona ka kapacitet të furnizimit në sasi prej 100%.

Investimet e Planifikuara në Sistemin e Furnizimit me Ujë

Investimet e planifikuara në sistemin e furnizimit me ujë janë ndarë në 4 nënkategori:

- (i) Investimet në burimet e reja të ujit,
- (ii) investimet në zgjerimin e sistemit të ujësjellësit,
- (iii) investimet në rehabilitimin e sistemit të ujësjellësit dhe
- (iv) investimet në matje dhe automatizim.

Vlera totale e planifikuar e këtyre investimeve është: **49,859 milion EUR**. Në burime të reja është paraparë vetëm (2.3 mil euro) për fshatrat e Rekës së keqe. Investimet tjera të planifikuara në sistemin e ujësjellësit përfshijnë:

- | | | |
|-------|---|------------------------|
| (i) | rehabilitimi i sistemit të ujësjellësit | 29,543 milion EUR, |
| (ii) | zgjerimi i sistemit të ujësjellësit | 11,800 milion EUR; dhe |
| (iii) | matje dhe automatizim | 6.216 mil EUR. |

Investimet e Planifikuara në Sistemin e Kanalizimit

Investimet e planifikuara në sistemin e kanalizimit janë ndarë 3 nënkategori:

- (i) investimet në zgjerimin e rrjetit të kanalizimit,
- (ii) investimet në rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit, dhe
- (iii) investimet në trajtimin e ujërave të ndotura të kanalizimit.

Në total investimet në sistemin e kanalizimit janë planifikuar të jenë: **27,25 milion EUR**, prej të cilave:

- (i) në zgjerimin e rrjetit të kanalizimit: 0,90 milion EUR,
- (ii) në rehabilitim të rrjetit: 13,53 milion EUR, dhe
- (iii) në ndërtimin e impiantit për Gjakovë: 12,81 milion EUR.

Vlera e përgjithshme e investimeve që ka planifikuar Kompania në periudhën 10-vjeçare është rreth **77,113 milion EUR**, përfshirë këtu investimet në sistemin e furnizimit me ujë në vlerë **49,859,984 €**, dhe investimet në sistemin e kanalizimit në vlerë prej **27.253,711 €**.

Dinamika e Planifikuar e Investimeve

Investime me prioritet në sistemin e furnizimit me ujë konsiderohen zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat e Rekës së Keqe në KK Gjakovë në zonën e shërbimit të Kompanisë. Me këtë edhe për dy vite zona e mbulueshmërisë do të mbërrijë në 100% me furnizim me ujë .

Dinamika e investimeve të planifikuara në sistemin e kanalizimit është ndarë në periudhën 2018-2023, dhe 2024-2028.

Përderisa në periudhën e parë planifikohet të ndërtohet impianti i trajtimit të ujërave të zeza të Gjakovës, investimet tjera të planifikuara do të shtrihen përgjatë tërë periudhës 10-vjeçare.

Burimet e investimit

Investimet e planifikuara nga të hyrat e Kompanisë, janë bazuar në:

- (i) trendin historik të investimeve dhe
- (ii) investimet e planifikuara dhe të miratuara me procesin tarifar 2018-2020.

Bazuar në këta parametra, planifikohet që kompania me të hyrat e veta do të investojë në total në periudhën e ardhshme 10-vjeçare, projekte në vlerë: **6,650,740 EUR**. Këto investime do të përfshijnë kryesisht investime në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Sigurisht që realizimi i këtyre investimeve do të varet nga ecuritë e përgjithshme të afarizmit të Kompanisë, dhe duhet që paraprakisht të shqyrtohen dhe miratohen përmes procesve të rregullta tarifore të zhvilluara dhe mbikëqyrura nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit.

Investimet nga burimet tjera, që mund të jenë grantet e Qeverisë apo donatorët ndërkombëtarë, janë në vlerë mbi; **70.462,955 EUR**, paraqesin pjesën më të madhe të investimeve të planifikuara në numër dhe në vlerë financiare.

Duke pasur parasysh lartësinë e investimeve të parapara me PAI, strukturën e këtyre investimeve si dhe kapacitetet e Kompanisë për financimin e këtyre investimeve, mund të nxjerren konkluzionet vijuese:

- 1) **Është evidente që nevojat për investime në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit të Kompanisë janë mjaft të mëdha.** Këto nevoja para së gjithash rezultojnë nga mungesa e resurseve të mjaftueshme të ujit për pjesën e fshatrave të Rekës së keqe ku duhet të investohet për resurse ujore.
- 2) **Vlera e parallogaritur e këtyre investimeve në lartësi prej 77,113 milion EUR e tejkalon shumëfish kapacitetin financues të Kompanisë.**
- 3) **Pjesa më e madhe e investimeve (18.28%) i atribuohet zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit në të ardhmen** në vlerë rreth 14,100,000 EUR. Këtu parashihen furnizimet për 28 fshatra të Rekës së Keqe si dhe gypsjellsit kryesor për qytetin e Suharekës, Malishevës, dhe disa fshatrave deri në ato qytete. Ndërsa për rehabilitimin e sistemit të ujësjellsit janë planifikuar; 28,543,474 EUR, apo (37.01%). Është paraparë gjithashtu që të investohet në sistemin e matjes dhe automatizimit 6.216,510 EUR, apo në (8.06%) si dhe që të ndërtohet gypsjellsi i ri prej Stacionit të Filtrimit deri në Rahovec paralel më gypsjellësin e vjetër. Donacionet parashihet të sigurohen nga Qeveria e Kosovës si dhe nga donatorë të jashtëm.
- 4) **Pjesa më e madhe e investimeve të planifikuara në sistemet e kanalizimit janë destinuar për ITUN dhe ndrrimin e dy kolektorëve** (12,817,045 EUR - ose 47.02%), ndërkaq për rehabilitimin e rrjetit janë planifikuar 13,536,666 EUR, apo 49.66%, përfshirë donacionet nga Faza V dhe VI nga KFW dhe Qeveria Zvicerane. Ndërsa zgjerimin e rrjetit të kanalizimit një shumë dukshëm më e vogël – 900,000 EUR, apo 3.3%. Këto investime pritet të financohen përmes grantit qeveritar dhe/ose kontributit të donatorëve ndërkombëtar, meqenëse Kompania realisht nuk ka kapacitet për financimin e tyre.
- 5) **Kompania ka paraprë që me mjetet e realizuara nga të hyrat e veta të investojë një shumë prej 1.66 milion EUR, kryesisht në rehabilitimin e sistemit të ujësjellësit, matjen e ujit, dhe në rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit.**

1. Hyrje

Plani afatgjatë i investimeve (në tekstin e më tutjeshëm: PAI) është një dokument planifikues për një periudhë planifikuese 10-vjeçare. Në të përshkruhen arsyet për investime dhe implikimet e përcaktimeve për investime me të cilat synohet përmbushja e nevojave të furnizimit me ujë dhe kanalizimit përgjatë periudhës planifikuese. PAI është në harmoni dhe i integron proceset tjera të planifikimit strategjik të Kompanisë Rajonale të Ujësjetllësit Gjakova sh.a. (në tekstin e më tutjeshëm Kompania).

1.1 Qëllimi i planit

Qëllimi parësor i PAI është që të analizohen dhe të trajtohen:

- (i) cilët janë faktorët që ndikojnë në nevojën për investime,
- (ii) cila është strategjia e Kompanisë për ballafaqimin me këta faktor, dhe
- (iii) cilat janë arsyet për orientimin afatgjatë të investimeve që planifikohen.

Ky qëllim mund të arrihet nëse me rastin e hartimit të PAI, Kompania (i) ka një qasje kritike sa i takon mundësisë që modeli i saj aktual i operimit të adresoj objektivat strategjike të përcaktuara me PAI, dhe (ii) i shpjegon faktet që duhet të arrihen gjatë periudhës planifikuese sa i përket aspekteve financiare, të performancës dhe cilësisë së shërbimeve.

1.2 Objektivat e planit

Objektivat e PAI janë që:

- (i) t'i identifikojë kërkesat e infrastrukturës së ujësjetllësit dhe kanalizimit të Kompanisë përgjatë periudhës së ardhshme 10-vjeçare, duke marrë parasysh trendin e rritjes dhe zhvillimit të zonës së shërbimit që është nën menaxhim të Kompanisë;
- (ii) t'i planifikojë investimet në infrastrukturën e ujësjetllësit dhe kanalizimit bazuar në kërkesat që vijnë si rezultat i projeksioneve demografike dhe zhvillimore në zonën e shërbimit apo si rezultat i kërkesave rregullatore për nivelin e shërbimeve dhe faktorëve tjerë (ndryshimet klimatike, vjetërsia e infrastrukturës etj.).

1.3 Zona e shërbimit

Zona e shërbimit të Kompanisë përfshin komunat:


- Gjakovë,
- Rahovec
- Prizren (fshatrat),

Mendohet që vitet në vijim pas vitit 2019, kapacitetet e prodhimit do të rriten në 1000 l/sec, dhe kompania mund të ofrojë shërbime edhe në Komunat tjera.

Kompania ofron shërbimet e veta edhe në fshatrat e këtyre komunave. Numri i përgjithshëm i popullatës brenda zonës së shërbimit të Kompanisë është: **173.075** ndërsaq numri i popullatës të cilës i ofrohen shërbimet e Kompanisë është :**155.569** banorë.

Në figurën 1 në vijim është paraqitur harta me territorin e zonës së shërbimit të Kompanisë.

Figura 1: Zona e shërbimit të KRU Gjakova



Në fund të vitit 2019, planifikohet të hynë në zonën e shërbimit me furnizim me uji edhe 28 fshatra të Rekes së Keqe, në Komunën e Gjakovës.

1.4. Kapacitetet e prodhimit të ujit

Kapacitetet aktuale të prodhimitme të cilat furnizohet e tërë zona e shërbimitjanë 1097 l/s (shih tabelën më poshtë).

Tabela 1: Kapacitetet e prodhimit të KRU Gjakova

Burimi	ITUP FAZA I & II	Burimi në Damjan	Gerqinë	Senoc	Drenoc	Opterush	Hoqë e Madhe	Total [l/sec]
Kapaciteti (l/s)	500	50	30	3	6	4	4	597
	500							1097

1.5. Aspektet administrative dhe institucionale

KRU Gjakova, është shoqëri aksionare në e cila e ka statusin ligjor të ndërmarrjes publike në pronësi të Republikës së Kosovës. Ajo është e licencuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU) për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimit të ujërave të ndotura (mirëmbajtja dhe operimi i kanalizimit atmosferik nuk është në përgjegjësi të Kompanisë - është përgjegjësi e komunave respektive).

Kompania i ka zyrat qendore në Gakovë ndërkaq në qytetet tjera i ka zyrat e njësive operative për komunat tjera të cilat janë në kuadër të zonës së shërbimit të Kompanisë (NJ.O Rahovec dhe NJ.O. Prizren (Lumbardhi).

Kompania qeveriset nga Bordi i Drejtorëve të cilin e emëron qeveria e Kosovës, ndërsa autoriteti kryesor ekzekutiv është Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë. Struktura organizative e Kompanisë është dhënë në shtojcën 1, te këtij dokumenti.

1.6 Aktivitetet e planifikuara të Kompanisë

Kompania është e përkushtuar për ndërmarrjen e të gjitha aktiviteteve investive dhe operative me qëllim të krijimit të një infrastrukture të konsoliduar të ujësjellësit dhe kanalizimit në interes të ofrimit të shërbimeve cilësore për konsumatorët e vet sot dhe në të ardhmen. Në këtë kontekst, Kompania është e përcaktuar që brenda periudhës së ardhshme 10-vjeçare t'i shtojë kapacitetet e vetapërpunuese edhe për 500 l/sec, në mënyrë që t'i shtrijë shërbimet në të gjitha vendbanimet e rajonit të Gjakovës dhe më gjerë, respektivisht në tërë territorin e 3 komunave që është në kuadër të zonës së shërbimit të Kompanisë, duke synuar shtrirje edhe në Komunën e Mamushës, Suharekës dhe Malishevës (furnizim me ujë/shitje e ujit). Gjithashtu, brenda periudhës së ardhshme 10-vjeçare, me mbështetjen e donatorëve (KFW dhe Seco) dhe Qeverisë, Kompania ka filluar të ndërtojë impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura për qytetin e Gjakovës dhe të merr në menaxhim Impiantin në fshatin Skivjan dhe në fshatin Marmullë.

Kompania në vazhdimësi po ndërmerr masa për arritjen e synimit të mësipërm. Kështu, me Planin e Biznesit për periudhën 2019-2021 Kompania ka paraparë investime kapitale për shërbimet e ujit dhe kanalizimit në lartësi prej; **59,758,695 EUR**.

Vlera më e madhe e investime ka të bëjë me ndrrimin e rrjetit të ujësjellësit, ndrrimin e gypave asbest cedent, kurse mbulimi i kanalit derivues dhe fabrika e ujit të pijes kanë të bëjnë me kuvendet komunale dhe Qeverinë dhe donatorët.

Përveq investimeve infrastrukturore, Kompani ka paraparë edhe investimet jo infrastrukturore dhe janë investimet në makineri, IT Pajisje, softuer, pajisje elektro-mekanike, pajisjet për detektimin e humbjeve, vegla pune, shqyrtimi i pajisjeve elektro energjetike etj.

Nëse merren total investimet 2019-2021, ato për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza dhe ato infrastrukturore vlera totale është: **59,758,695 EUR**.

Arsyeja kryesore e këtyre investimeve ka të bëjë me ngritjen e cilësisë së shërbimeve të cilat ju ofrohen konsumatorëve duke ndërruar dhe zgjeruar rrjetin e ujësjellësit, duke zvogëluar humbjet e ujit në rrjet, duke përmirësuar sistemin e ujësjellësit në sistem, duke rritur kapacitetin e prodhimit të ujit, përmirësimin e matjeve, mjeteve të punës veglave, pajisjeve etj.

Planifikohet që në vitin 2019, KRU "Gjakova" SH.A. , ta zgjerojë zonën e shërbimit në 99 %, duke llogaritur përfshirjen e 28 fshatrave të Rekës së Keqe, dhe pastaj mbulueshmëria e zones do jetë 100 % .

1.7 Struktura e Planit Afatgjatë të Investimeve (PAI)

PAI është strukturuar si vijon:

Kapitulli 2, jep një përmbledhje të informacioneve të disponueshme lidhur me investimet e planifikuara me dokumentet ekzistuese planifikuese të cilat kanë të bëjnë zhvillimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit të Kompanisë.

Kapitulli 3, e përshkruan qasjen dhe metodologjinë për hartimin e PAI. Në këtë kapitull janë përfshirë të dhënat për infrastrukturën ekzistuese të ujësjellësit dhe kanalizimit që menaxhohet nga Kompania, e cila shërben si bazë për projeksionet e planifikuara me PAI.

Kapitulli 4, jep një pasqyrë në lidhje me kërkesat për ujë, kapacitetet e sistemit, skenarët dhe rezultatet e fituara nga analizat e kryera. Këto analiza janë të bazuara në projeksionet e zhvillimeve demografike dhe të planeve hapësinore dhe urbane.

Kapitulli 5, përmbledh investimet e planifikuara afatgjata për periudhën planifikuese me të dhënat relevante për investimet e planifikuara.

2. Dokumentet e shfrytëzuara

2.1 Plani i Biznesit 2018-2020

Me Planin e Biznesit (në tekstin e mëtuftjeshëm: PB) të Kompanisë për periudhën 2018-2020 janë planifikuar investime të konsiderueshme në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Investimet më të mëdha janë planifikuar në dy projekte:

- 1) Ndërtimi i Fabrikës për përpunimin e ujit të pijes -Faza II, me kapacitet 500 l/sec, e cila është ndërtuar me një vlerë financiare 7,021,000 Eur.
- 2) Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura për qytetin e Gjakovës. Impianti është paraparë të ndërtohet në lagjen *Zidi i Sadik Agës*, dhe vlera e paralogaritur e investimeve është planifikuar **12,81 milion EUR**. Me këtë projekt është planifikuar edhe rehabilitimi i dy kolektorëve kryesor të kanalizimit.

Projektet tjera përfshijnë kryesisht rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit, krijimin e zonave të matura (DMA), si dhe investime modeste në rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit.

Arritjet kryesore pas këtyre investimeve do të jenë:

- Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetë;
- Zgjerimi i sistemit të rrjetave të reja në vendbanime;
- Ndërrimi i gypave profili i të cilëve ka qenë i pamjaftueshëm për nevoja të konsumatorëve, të cilat janë punuar nga materiale joadekua të ose në ato gypa janë defekte të përsëritshme;
- Përmirësimi i funksionimit të sistemit;
- Ngritja e nivelit të sigurisë punuese të sistemit të furnizimit me ujë, domosdoshmëria e pajisjeve telemetrike, mjete të reja pune etj
- Përmirësimi i matjeve të ujit në sistem dhe te konsumatorët.

2.2. Plani i Menaxhimit të Emergjencave

Plani i Menaxhimit të Emergjencave është një dokument tjetër planifikues i hartuar nga Kompania. Në të janë përcaktuar veprimet e Kompanisë për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera që potencialisht mund të ndodhin e që mund të rrezikojnë furnizimin me ujë të popullatës. Me këtë plan janë paraparë investime të cilat janë në funksion të parandalimit dhe zbutjes së efekteve të fatkeqësive eventuale. Këto masa përfshijnë para së gjithash investimet në lidhje me sigurinë e digës te Liqeni i Radoniqit, në kuptim të monitorimit dhe sistemit të alarmimit si dhe në kuptim të stabilitetit fizik të digës. Këto aktivitete përpunohen më detajisht në PB të Kompanisë.

2.3 Plani i Menaxhimit të Thatësisë

Edhe pse ky plan përmban masa emergjente, dallimi i tij esencial me planin e menaxhimit të emergjencave është se, qëllimi parësor i këtij plani është që të parandalojë paraqitjen e situatës së thatësisë përmes: (i) vlerësimit paraprak të rrezikut nga thatësia dhe ndjeshmërisë ndaj thatësisë si

dhe të kapacitetit adaptues ndaj thatësisë të zonës së burimit të ujit ndaj periudhave të mungesës së ujit, (ii) konstatimit të sasisë së disponueshme të ujit për shfrytëzim, gjatë operimit normal si dhe gjatë periudhave kohore me intensitet të shtuar të thatësisë, dhe (iii) ndërmarrjes së veprimeve të duhura për ruajtjen e resurseve ujore bazuar në treguesit e paracaktuar në rast se arrihet faza e thatësisë. Investimet e nevojshme për zbutjen e efekteve të mundshme të thatësisë, sikurse edhe me rastin e emergjencave, përpunohen më në detaje me PB të Kompanisë për periudhat e rregullta 3-vjeçare.

2.4 Strategjia e Zvogëlimit të Humbjeve të Ujit

Strategjia për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit përfshin periudhën 5 vjeçare, 2018-2022, dhe me të janë përshkruar aktivitetet dhe projektet që planifikon Kompania gjatë kësaj periudhe për zvogëlimin e humbjeve të ujit.

Me këtë plan janë paraparë investime të cilat kryesisht lidhen me (i) matjen e ujit të konsumatorëve individual (me qëllim të zvogëlimit të humbjeve komerciale) si dhe (ii) investime për zëvendësimin e rrjetit të ujësjellësit (me qëllim të zvogëlimit të humbjeve fizike).

Sa i përket matjes së ujit, janë planifikuar të blihen dhe të instalohen rreth 13,000 ujëmatës individual prej të cilëve rreth 1,000 të tipit 'inteligjent' ('smart meters'). Ndërkaq sa i takon investimeve për zvogëlimin e humbjeve fizike, Kompania ka planifikuar që të:

- Zëvendësojë 24,624 metra rrjet shpërndarës,
- 4,000 kyçe shtëpikake,
- Krijojë zonat matëse – DMA,
- Krijojë zonat e presionit.

2.5 Studimi i Fizibilitetit për Trajtimin e Ujërave të Kanalizimit

Në kuadër të bashkëpunimit bilateral ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë, janë parashikuar fonde granti në shumë prej 8.0 milionë EUR për projektin "Eliminimi i Ujërave të Ndotura në Jugperëndim, Faza V" në qytetet e Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura për të kontribuar në mbrojtjen e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe përmirësimin e kushteve të jetësore të popullsisë. Nga kjo vlerë e lartëcekur KRU Gjakova do përfiton: **2,043,333€**.

Konfigurimi i projektit

Një nga detyrat kryesore të Fazës paraprake V të Projektit të Eliminimit të Ujërave të Ndotura¹ (në një fazë të hershme të implementimit) është:

- Që të kompletohet informacioni për tërë rrjetin e kanalizimeve dhe të ujërave atmosferike (pusetat, nivelet, diametrat, materialet) në GIS,
- Që të analizohet rrjeti i kanalizimit në ato pjesë të qyteteve që do të lidhen me impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura të cilat do të ndërtohen,
- Që të dokumentohen rezultatet e kësaj analize në GIS,
- Që të identifikohen prishjet dhe problemet strukturore bazuar në analizë,

¹Draft Marrëveshja e Investimeve për fazën e V-të (KFW, Qeveria e Kosovës)

- Që të përcaktuar dhe jepet prioritet nevojave për investime dhe rehabilitim, dhe
- Që të implementohen riparimet që kanë prioritet, rehabilitimin dhe masat e zëvendësimit në ato pjesë të qyteteve që do të lidhen me impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

Brenda Fazës VI, Bashkëpunimi Financiar përmes Bankës për Zhvillim të KFW do të financojë riparimet me prioritet, si dhe masat e rehabilitimit dhe zëvendësimit bazuar në punën fillestare që është bërë në Fazën V.

Për të përgatitur dhe mbështetur Fazën VI të Projektit, do të kryhet një studim i fizibilitetit. Studimi do të rezultojë me një propozim të saktë të Projektit.

Pjesa më e madhe e ujërave të ndotura të grumbulluara në Gjakovë rrjedh përmes dy kolektorëve të ujërave të ndotura të cilat me gravitet transportojnë ujërat e ndotura nga Veriu në Jug deri në një pikë shkarkimi në lumin Erenik në pjesën jugore të qytetit. Mbetjet e strukturave të para-trajtimit të një ITUN të vjetër ende gjenden atje. Aktualisht kjo strukturë nuk funksionon dhe nuk i shërben për asnjë qëllim.

Përveç pikës kryesore të shkarkimit në lumin Erenik, ka edhe pikat e tjera zyrtare të shkarkimit:

1. Pika e shkarkimit të pjesës veri-lindore të qytetit në lumin Llukac
2. Pika e shkarkimit të qytetit të vjetër në lumin Krena
3. Pika e shkarkimit të Brekocit në një prrua të vogël që derdhet në lumin Erenik
4. Disa pika shkarkimi të banorëve përgjatë lumit Krena në lumë (8 pika shkarkimi).

2.6 Projektionet demografike – shtimi i popullsisë

Vlerësimi i popullsisë së Kosovës ka për qëllim të sigurojë një vlerësim të saktë statistikor mbi popullsinë, i nevojshëm për institucione, organizata dhe individë, njëherit është praktike dhe standard që kërkohet të bëhet çdo vit nga institucionet zyrtare të statistikave të një vendi. Kjo për faktin se në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve (dhjetëvjeçare) ndodhin ndryshime të theksuara në popullsinë e një vendi, komune a vendbanimi dhe vlerësimi i popullsisë është me se i nevojshëm për nxjerrjen e indikatorëve të rëndësishëm socio-ekonomik. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) do të vazhdojë të bëjë vlerësimin, çdo vit, të numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune. Të dhënat vjetore statistikore mbi popullsinë janë themelore për studimin dhe përcaktimin e një game të gjerë analizash me çështjet sociale dhe ekonomike në nivele të caktuara komunale, kombëtare dhe rajonale. Statistikat mbi popullsinë janë një emërues dhe tregues i rëndësishëm i vendimmarrësve, analistëve, hulumtuesve dhe shfrytëzuesve të ndryshëm të të dhënave

Projektionet e rritjes së popullsisë në Kosovë janë analizuar² nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Sipas këtij dokumenti janë shqyrtuar 3 skenarë të parashikimit të popullsisë:

Skenari i mesëm, skenari i lartë dhe skenari i ulët (shih tabelën e mëposhtme 3).

²Parashikimi i Popullsisë së Kosovës 2017-2061, ASK, dhjetor 2017

Tabela 2: Popullsia e Kosovës sipas grup moshave dhe viteve (varianti i mesëm)

Vitet	Varianti i ulët	Varianti i lartë	Varianti i mesëm
2017	1,783,531	1,783,531	1,783,531
2021	1,750,206	1,888,375	1,809,458
2028	1,643,206	2,070,125	1.824.952

Figura 2: Grafiku i parashikimeve të popullsisë së Kosovës




Tabela 3: Të dhënat e popullsisë për komunat e zones së shërbimit të KRU Gjakova

Komuna	Gjakovë	Rahovec	Prizren	Gjithsej
Popullsia 2018	99,889.12	59,118.00	14,068.00	173,075
Popullsia 2026	99,889.12	59,781.00	15,068.00	174,738
Popullsia 2028	100,876.12	59,928.00	15,568.00	176,372

Të dhënat e popullsisë³ për komunat të cilat janë në zonën e shërbimit të Kompanisë janë dhënë në tabelën 3 më poshtë.

³Moduli kompleks i balancit kërkesë-furnizim me ujë për KRU 'GJAKOVA' (Vera Muhaxhiri)

2.3 Planifikimi urban

2.3.1 Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+

Me Planin Hapësinor të Kosovës për periudhën 2010-2020+, ndër tjera është planifikuar: Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe degradimi, duke realizuar keto aktivitete.

- Ndalimi me ligj i nxjerrjes së inerteve nga shtretërit e lumenjve, nga operator të pa licencuar.
- Ndalimi i hedhjeve të mbeturinave në shtretërit e lumenjve.
- Të sigurohet mbrojtje më efikase në deponitë e materieve të rrezikshme që mund të shkaktojnë katastrofa në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore
- Të ndërtohen impiantet për pastrimin e ujërave të zeza nga kanalizimet e vendbanimeve.
- Ndalimi i çdo aktiviteti mekanik në shtretërit e lumenjve me makineri operuese.
- Të ndalohet larja e mjeteve motorike dhe pajisjeve tjera në ujërat sipërfaqësore
- Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtja e tyre nga të gjitha nivelet e qeverisjes.
- Eliminimi i të gjitha deponive ilegale të cilat bëjnë ndotjen e ujërave

Pasuria e një shteti çmohet edhe për nga pasuritë ujore⁴. Ujërat në Kosovë shfrytëzohen për pije, për furnizim të industrisë, ujitje, rekreacion etj. Kosova bën pjesë në rajonet me sasira të limituara të resurseve ujore me rreth 1600 m³/banor. Dendësia e madhe e popullsisë dhe vendbanimeve, rritja e qendrave urbane, shfrytëzimi i ujit nga sektorët ekonomikë, shtimi natyror i popullsisë kushtëzojnë nevojën e menaxhimit të veçantë të resurseve ujore në Kosovë.

Për nga sasia e ujit të akumuluar, liqeni më i madh është ai i Gazivodës, me vëllim 390 mil.m³ ujë, i Radoniqit me 117 mil.m³ ujë, pastaj i Badovcit me 31 mil.m³ (kur ka qenë i plotë), i Batllavës 30 milion m³, i Përlepnicsës 4,2 mil.m³, i Livoçit 1 mil.m³ dhe i Pridvoricsës 0,49 mil.m³ ujë.

Rreth 28% e popullatës në Kosovë është e kyçur në sistemin e kanalizimit⁵ të ujërave të zeza (rreth 25% në zonat urbane dhe 3% në ato rurale). Në Kosovë nuk kemi asnjë impiant për pastrimin e ujërave të ndotura nga vendbanimet urbane dhe rurale. Ujërat e zeza janë njeri nga ndotësit e lumenjve dhe ujërave nëntokësore, prandaj shtrohet nevoja e ndërtimit të fabrikave për pastrimin e ujërave të zeza. Impiantet për pastrimin e ujërave të ndotura industriale kanë filluar të ndërtohen paralel me ndërtimin e kapaciteteve prodhuese dhe kanë funksionuar vetëm në periudhën provuese, kurse më vonë janë lënë jashtë funksionit.

Një numër i akumulacioneve për këtë rajon janë paraparë edhe me Strategjinë Shtetërore për Ujëra 2017-2036.

2.3.2 Plani Zhvillimor i Komunës së Gjakovës 2006–2015+

Gjakova shtrihet ndërmjet Prizrenit dhe Pejës. Për nga madhësia është qyteti i dytë në rajon. Para luftës Gjakova ishte qendra më e rëndësishme industriale. Momentalisht (2006), shumica e

⁴Planin Hapësinor të Kosovës për periudhën 2010-2020+,

⁵ Këto janë të dhëna të vjetra. Aktualisht rreth 80% të populates janë të përfshirë me sisteme të kanalizimit

kapaciteteve industriale nuk e kanë rifilluar prodhimin. Qyteti ka lidhje të drejtpërdrejt rrugore me Shqipërinë, Prishtinën dhe të gjitha qytetet kryesore në rajon. Bjeshkët tjera që e rrethojnë Gjakovën, në rrafshin e Dukagjinit janë të gjitha te rëndësisë së vogël ekonomike-turistike, dhe me popullsi të pakët.

Gjakova shtrihet në një peizazh mjaft atraktiv, malet e larta të prera përmes nga lumenjtë e mëdhenj, kodrinat dhe fushat e gjelbra. Gryka e Drinit, liqeni i Radoniqit dhe parku memorial i Çabratit, janë pjesët e trashëgimisë së pasur natyrore. Nuk janë vetëm potencialet ato që shfrytëzohen shumë, shumica prej tyre janë të kërcënuara nga një rritje e ndotjes, dhe vetëdija e ulët e popullsisë në lidhje me vlerat e tyre.

Qyteti është shtrirë në drejtim të pjesës verilindore. Pas luftës së Dytë Botërore, një qendër e re e qytetit është ndërtuar në bregun lindor të lumit Krena. Janë ndërtuar shkolla, parqe dhe një spital. Qyteti gjithashtu zhvillohej në një qendër industriale. Degët më të rëndësishme ishin: industria e përpunimit të metalit, tekstilit, materialit ndërtimorë, përpunimit të drurit si dhe industria e përpunimit të produkteve bujqësore. Sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban 2006 - 2015 Qyteti pritet që të zgjerohet në formë rrethore. Megjithatë, zhvillimet e parashikuara sa i përket lidhjeve hekurudhore me Pejën dhe Shqipërinë, zgjerimi i zonave industriale dhe zgjerimi i zonave të banimit shtëpiak dhe të përzier. Prandaj, Konsulenti ka zhvilluar një parashikim të përshtatur me një rritje më të moderuar.

Tabela 4: Parashikimi i Zhvillimit Urban të Gjakovës

Lokacioni / modeli i zhvillimit	Parashikimi i zhvillimit urban (ha) ⁶				
	2011	2016	2021	2036	>2036
Qendra/Qyteti i Vjetër	280	290	290	290	290
I përzier dhe rezidencial	260	260	312	383	539
Komercial / Industrial	110	110	126	140	254
Hapësira e Hapur	1,250	1,240	1,172	1087	817
Total	1,900	1,900	1,900	1,900	1,900

2.3.3 Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit: 2010–2020+

Komuna e Rahovecit zë sipërfaqen prej 275.5 km²⁷, në të cilin territor shtrihen 36 vendbanime, me vetëm një qendër urbane. Territori i komunës së Rahovecit⁸ ndahet në 35 zona kadastrale, ndërsa brenda një zone kadastrale ndodhet një vendbanim, me përjashtim të vendbanimit Sarosh i cili ndodhet në zonën kadastrale të vendbanimit Çifllak.

Zhvillimi ekonomik në komunën e Rahovecit është orientuar me së shumti në bujqësi, vreshtari dhe perimkulturë. Afro 65% e popullatës është vlerësuar të sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore. Mesatarja vjetore e të ardhurave për një fermer është përafërsisht 2,500 - 3,000 €. Komuna plotësisht

⁶Rehabilitimi I ujërave të zeza në Gjakovë, faza III

⁷Plani Zhvillimor Komunal Rahovec 2010-2020 +

përfiton nga kushtet e favorshme topografike, klimatike dhe agro-ekologjike, ku cca 13,000 ha sipërfaqe është tokë punuese, prej te cilave 3,500 ha janë në sistemin e ujitjes.

Numri i farmerëve në komunë është 3,699 (numri i familjeve të cilat kanë më tepër se 0.5 ha), përderisa gjendja ekonomike paraqitet mjaft e rëndë. Përpos tregut të redukuar (në të kaluarën ka funksionuar tregu unik i ish Jugosllavisë dhe produkte janë plasuar anekënd ish Jugosllavisë), kemi të bëjmë me një import të pakontrolluar dhe joselektiv të produkteve bujqësore gjë që i bjen prodhuesit tanë të pemëve dhe perimeve, në pozitë mjaft të rëndë.

Padyshim që edhe Komuna e Rahovecit ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj infrastrukture. Kjo para së gjithash nënkupton interesin dhe përgjegjësinë e Komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore për pjesën e përfshirë të popullatës me këto shërbime, po ashtu dhe për zgjerimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e zonave aktualisht të pambuluara me këto shërbime. Qytetarët e komunës së Rahovecit furnizohen me ujë të pijshëm në tri forma:

- 1) sistemi qendror i furnizimit-ujësjellësi i KRU Gjakova
- 2) sistemet e vogla -ujësjellësit lokal (sistem të pompimit)
- 3) pusët individuale

Furnizimi i banorëve të komunës së Rahovecit me ujë të pijshëm momentalisht përcillet me probleme të mëdha. Me probleme përcillen edhe fshatrat që kanë sistemin e ujësjellësit e sidomos gjatë periudhës së nxehtë kur në shumë raste uji pijes keqpërdorët edhe për ujitjen e tokave.

Komuna e Rahovecit nuk ka rrjet shumë të zhvilluar të furnizimit me ujë të pijes, i cili ka shtrirje në 26 vendbanime ose 58% (komuna kadastrale), derisa pjesa tjetër e vendbanime ose 42% (komuna kadastrale) nuk kanë qasje në rrjetin e furnizimit publik me ujë të pijes. Aktualisht sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit në Komunën e Rahovecit menaxhohet nga KRU Gjakova. Furnizimi i komunës së Rahovecit me ujësjellës behet nga KRU Gjakova.

Për përmirësimin e gjendjes në tërë zonën është e domosdoshme të investohet në;

- Rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit qendror në zonën urbane me qëllim të zvogëlimit të humbjeve
- Zgjerim i rrjetit të ujësjellësit qendror në vendbanimin Qifllak, Polluzhe, Kramovik etj,
- Ndërtim i rezervuarit të ri për plotësimin e kërkesave të zonave të cilat shtrihen mbi 550 m lartësi mbidetare;
- Instalimin e sistemit të dezinfektimit të vazhdueshëm me klor,
- Rritja e prodhimit të ujit
- Ndërtimi i ujësjellësve lokal në vendbanimet ku janë të evidentuar burimet natyrore: Drenoc, Senoc, Pastasel, Kaznik, Guri i Kuq etj.

Në komunën e Rahovecit, kanalizimi i ujërave të ndotura është shumë pak i zhvilluar, përkatësisht ky sistem është i shtrirë në zonën urbane dhe në disa vendbanime rurale. Pjesa më e madhe e ujërave të zeza derdhen pa asnjë trajtim paraprak në shtratin e lumit Drin i Bardhë dhe në degët e tij. Derisa pjesa tjetër e ujërave të zeza rrjedhin në sipërfaqe të hapura që rrezikojnë përhapjen e sëmundjeve ngjitëse.

Vetëm 74.5% e popullsisë së komunës kanë qasje në rrjetën e kanalizimit publik, dhe 25.54% e popullatës së komunës ujërat e zeza i derdhen në mënyrë të egër në lokacione të ndryshme në vendbanimet ku jetojnë, përkatësisht në shtratin e përroskave dhe lumenjve. Sistemi i kanalizimit të ujërave të ndotura, gjendja e rrjetit të kanalizimit dhe mungesa totale e trajtimit të ujërave të ndotura në Komunë, çon në ndotje të lumenjve, tokës dhe sigurisht edhe ujit nëntokësor, andaj ndërtimi i impiantit për përpunimin e ujërave të ndotura do t'i eliminonte të gjitha rreziqet dhe brengat.

Si zgjidhje afat shkurte, sidomos në zonën e kopshtëve, propozohet ndërtim i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe gropave septike në zonat e qendrave sekondare në vendbanimet Krushe e Madhe dhe Ratkoc. Rrjeti i kanalizimit në këto teritore do të përmbledhë ujërat e zeza në sipërfaqen me të madhe të vendbanimeve të zonës së kopshteve. Gjithashtu propozohet zgjerim i rrjetit në zonën urbane dhe në zonat sekondare si dhe ndërtimi i gropave septike adekuate. Në këtë drejtim duhet ndërtohet rrjeti i veçantë i ujërave të zonës industriale dhe të bëhet trajtim adekuat i tyre.

2.3.4. Plani Zhvillimor i Komunës së Prizrenit 2013 – 2025

Komuna e Prizrenit ka një sipërfaqe prej 640 km² (5.94% të sipërfaqes së Kosovës), e vendosur në pjesën jug-perëndimore të [Kosovës](#) ka 76 vendbanime me 220,776 banorë, të cilët 110,000 janë të Prizrenit, banorë lokal.

Pozita gjeografike dhe rajonale të Prizrenit më së miri mund të shqyrtohet me analizën e pozitës së tij në raport me Kosovën dhe rajonin e Dukagjinit.

Pozita e mirë gjeografike, rajonale dhe resurset e pasura natyrore, pasuria historike e artefakteve kulturore formon bazën e zhvillimit të turizmit në komunën e Prizrenit.

Topografia e Prizrenit ka një strukturë të valëzuar. Lartësia mbidetare shkon nga 300 deri në 2,600 metra brenda kufijve të komunës.

Ndërsa qendra e qytetit është e përqendruar në sipërfaqe të sheshtë, topografia kodrinore është vërejtur përgjatë anës perëndimore, sidomos përgjatë anës lindore.

Nga shuma e përgjithshme e reshjeve që bie në territorin e Kosovës, në rajonin e Dukagjinit bien rreth 800 mm në 1 m² të sipërfaqes, ndërsa në Kosovë, rreth 600 mm në 1 m². Me rrjedhjen e lumit rreth 40% është mbetje (fundërrinë), perderisa rreth 60% avullohet. Sasia e ujit që derdhet në lumenj është më e madhe në fund të vjeshtës dhe të pranverës, dhe më e ulët në verë dhe dimër.

Rrjedha maksimale e ujit në lumenjë vijnë⁹ nga [Sharri, Në Lindjen e Alpeve shqiptare](#), nganjëherë mund të vonohen deri në vjeshtë (nëntor dhe dhjetor), kur këto rajone kanë reshje të pandërprerë për disa ditë. Përndryshe, për shkak të verës të gjatë dhe të thatë, në vjeshtë nuk ka shumë ujë në këto lumenj, ndërsa rezervat nëntokësore në male nuk janë të mbushur.

Deri në fund të vitit 2018, do të bëhet zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Lubizhdë me 2,900 banorë, ku do furnizohen direkt nga fabrika e përpunimit të ujit. Gjithashtu është planifikuar ndërtimi i rrjetit sekondar në këtë fshat. Planifikohet zgjerimi i furnizimit edhe në fshatra tjera të komunës së Prizrenit.

⁹Plani Lokal i Veprimit Komuna e Prizrenit 2007-2013 +

3. Metodologjia

3.1 Të dhënat e përgjithshme

Përpilimi i PAI -it, për periudhën 10-vjeçare kërkon marrjen parasysh, për atë që është e mundur, të të gjithë faktorëve që kanë të bëjnë me shtimin e popullsisë, zhvillimin dhe planifikimin urban, resurset ekzistuese ujore, parashikimi i kërkesave për ujë, analizat hidraulike, investimet e parashikuara dhe burimet e mundshme të investimeve.

Duhet theksuar se me rastin e hartimit të PAI-it, nuk janë bërë analiza ekonomike meqenëse natyra e këtij plani është që të identifikohen nevojat, ndërkaq analizat ekonomike për komponente të veçanta të këtij plani do të bëhen me rastin e planifikimeve të detajuara para se të realizohen të njëjtat.

3.2 Informacionet e shfrytëzuara

3.2.1 Plani i Biznesit 2018-2020

Investimet e planifikuara nga Kompania me Planin e Biznesit 2018-2020 janë pjesë integrale e investimeve afatgjata të kompanisë dhe rrjedhimisht do të përfshihen me PAI.

3.2.2 Planet zhvillimore

Me këtë PAI do të shfrytëzohen të dhënat e disponueshme të planeve zhvillimore në nivel të vendit dhe ato të komunave të cilat janë në kuadër të zonës së shërbimit të Kompanisë. Në këtë kuptim, janë shfrytëzuar dokumentet vijuese:

- Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+
- Plani Zhvillimor Komunal i Gjakovës 2006 – 2015+
- Plani Zhvillimor i Komunës së Rahovecit 2010 – 2020+
- Plani Zhvillimor i Komunës së Prizrenit 2013 – 2025+

3.2.3. Zhvillimet demografike

Shkalla e rritjes së popullsisë si dhe e zhvillimit urban dhe ekonomik duhet të merren në konsideratë me rastin e hartimit të këtij PAI. Kjo për faktin se zhvillimet demografike janë faktori kryesor në kalkulimin e kërkesës për ujë.

Për këtë qëllim janë shfrytëzuar të vlerësimet e popullsisë ekzistuese dhe parashikimet e popullsisë të kryera nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për periudhën 2017 – 2061. Me këtë rast, prej 3 skenarëve të shtimit të popullsisë të përpunuar nga ASK, është përvehtësuar si më real skenari i mesëm, sipas të cilit popullsia e komunave të cilat shërbehen nga Kompania, në periudhën e ardhshme 10-vjeçare do të rritet në një masë shumë të vogël prej 170,563 banor në 2018, deri në vitin 2028, do kete rritje në 176,372 banor.¹⁰

¹⁰Moduli kompleks i bilancit kërkesë-furnizim me ujë për KRU 'GJAKOVA' (Vera Muhaxhiri)

3.3 Vlerësimi i kërkesës për ujë

Sigurisht që parametri kryesor që influencon planifikimin e investimeve është shtimi i kërkesës për ujë që vjen si rezultat i dy elementëve: (i) shtimit natyror të popullsisë, dhe (ii) rritjes së shkallës së mbulueshmërisë me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit me qëllim të shtrirjes së shërbimeve në tërë zonën e shërbimit.

Sa i përket normës së konsumit, është marrë për bazë norma e konsumit prej **150 l/d/banorë**, ndërkaq për konsumatorët joshtëpiak normat e konsumit varësisht prej llojit të shfrytëzimit nga institucioni respektivisht aktiviteti komercial/industrial i planifikuar.

Shkalla e popullsisë aktualisht e përfshirë me shërbime të ujësjellësit është 96% (160,624 banorë prej 200,275). Mbulueshmëria është më e vogël në komunën e Gjakovës, si rezultat i mos përfshirjes së fshatrave të Rekes se Keqe (28 fshatra). Në vitin 2019, planifikohet mbulueshmëria e zonës me 100 % dhe afër 173,712 banorë.

3.4 Objektivat e Kompanisë

Objektivat e Kompanisë të përcaktuara me Planin e Biznesit dhe dokumentet tjera strategjike dhe planifikuese për periudhën e ardhshme 10-vjeçare të cilat kanë ndikim në PAI janë:

- a) Furnizimi me ujë të mjaftueshëm në pajtim me standardet e cilësisë për të gjithë konsumatorët 24 orë në ditë, (aktualishtë 24 orë);
- b) Zvogëlimi i humbjeve të ujit në nivelin 36%, (aktualishtë 44 %);
- c) Rritja e mbulueshmërisë me shërbime të furnizimit me ujë në tërë zonën e shërbimit në shkallën 100%, (aktualishtë 92%);
- d) Rritja e arkëtimit në shkallën 97% (aktualishtë 92%);
- e) Rritja e mbulueshmërisë me shërbimet e kanalizimit në shkallën 90%, (aktualishtë qyteti i Gjakovës dhe Rahovecit 95%, të tjerat/ fshatrat nën 50%);
- f) Trajtimi i ujërave të ndotura të kanalizimit në komunën Gjakovës dhe ndertimi i dy kolektoreve kryesor.
- g) Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza.

3.5 Plani i menaxhimit të aseteve

Plani afatgjatë i investimeve është ngushtë i ndërlidhur me planin e menaxhimit të aseteve. Një plan i mirë i menaxhimit të aseteve që bazohet në të dhëna kualitative të aseteve (si, vjetërsia, gjendja dhe kritikabiliteti) është një vegël shumë efektive që i mundëson Kompanisë së ujësjellësit planifikimin e masave dhe investimeve për mirëmbajtjen, përmirësimin dhe zëvendësimin e aseteve dhe, rrjedhimisht, mbajtjen e infrastrukturës fizike së ujësjellësit dhe kanalizimit në gjendje të mirë punë.

Meqenëse aktualisht Kompania nuk ka një plan të përpunuar të menaxhimit të aseteve, investimet në përmirësimin dhe zëvendësimin e aseteve do të planifikohen me këtë PAI, duke u bazuar në vlerësimin më të mirë që mund të bëhet në bazë të informacioneve të disponueshme.

3.6. Deklarata e nivelit të shërbimit për KRU "Gjakova" sh.a.

Deklarata e Nivelit të Shërbimit përcakton mënyrën në të cilën KRU "Gjakova", do të performojë në një plan afatgjatë. Kjo Deklaratë përfshinë komponentet teknike, komerciale, financiare dhe menaxheriale të cilat janë në përputhshmëri me atë që Kompania jonë synon të arrijë, për aq kohë sa të gjitha kërkesat rregullatore janë të përfshira.

Kjo Deklaratë nuk kufizohet vetëm në standardet minimale të shërbimit të përcaktuara nga ARRU por përfshinë edhe aspekte të tjera të shërbimit të Kompanisë që dëshirojmë t'i vendosim si një standard dhe që të njëjtat t'i komunikojmë me personelin dhe konsumatorët tonë. Këto aspekte përfshijnë:

- Krijimin e besimit dhe reputacionit karshi Konsumatorëve për shërbime të kënaqshme;
- Menaxhimin e cilësisë së qëndrueshme të ujit të pijshëm nga burimi deri te kroi për të mbrojtur shëndetin e konsumatorëve;
- Menaxhimin e disponueshmërisë, qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë së furnizimit me ujë tani dhe në të ardhmen;
- Menaxhimin e furnizimit me ujë në mënyrë efikase dhe ekonomike;
- Menaxhimin e disponueshmërisë së shërbimeve të ujërave të ndotura tani dhe në të ardhmen;
- Menaxhimin e funksionimit të objekteve të trajtimit të ujërave të ndotura në atë mënyrë që mbron cilësinë e mjedisit;
- Menaxhimin e shërbimeve të ujërave të ndotura në mënyrë efikase dhe ekonomike;
- Mbështetjen e politikave shtetërore, rajonale dhe lokale të planifikimit ekonomik dhe hapësinor;
- Menaxhimin e pasurive themelore dhe investimeve tona në përputhje me parimet më të mira rregullatore të menaxhimit të pasurive themelore për të ofruar një shërbim me cilësi të lartë dhe të qëndrueshëm me kosto sa më të ulët;
- Nxitjen e kërkimit dhe zhvillimit të zgjidhjeve teknike të provuara dhe inovative për të përmbushur standardet e vendosura nga rregullatorët e sektorit.

Tabela në vijim paraqet përshkrimin e Deklaratës së Nivelit të Shërbimit të KRU "Gjakova"

Përmbushja e cakut afatgjatë të secilës prej Masave specifike (nga OL.1 deri te M.2) do të përcjellët me projekte të veçanta investive, të cilat do të duhej të relizoheshin brenda 10 viteve planifikuese, në një ndarje propocione mes tyre.

Tabela 5: Përshkrimi i Deklaratës së Nivelit të Shërbimit

Obligimet ligjore (OL)	
Masa Specifike OL.1	Pajtueshmëria me standardet e cilësisë së ujit të pijshëm
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Pajtueshmëri 100% me standardet e përcaktuara përmes Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2012 për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor, për standardet mikrobiologjike dhe 100% për karakteristikat fiziko/kimike në burimet e ujit
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Përputhshmëri me Direktiven e BE për Cilësinë e Ujit të Pijshëm
Masa Specifike OL.2	Furnizimi me shërbimet e ujësjellësit, pa ndërprerje të planifikuara
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Furnizimi bëhet 24 orë, për të gjithë konsumatorët
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	24 orë furnizim për të gjithë konsumatorët
Masa Specifike OL.3	Furnizimi me shtypje standarde të ujit
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Shtypja mesatare është 5.3 për të gjithë konsumatorët, kemi përjashtime në zonat e larta në pjesën e Lumbardhit, ku presioni arrin deri 12 bar.
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Min. ≤ 1.5 bar Max. $\geq 7 - 10$ bar
Masa Specifike OL.4	Krijimi i zonave të mbrojtura ujore dhe posedimi i lejeve ujore për të gjitha burimet
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Në proces
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Krijimi i zonave të mbrojtura ujore në pajtueshmëri me Udhëzimin Administrativ MMPH Nr.15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit. Përtrirja e vazhdueshme e lejeve ujore për të gjitha burimet e ujit
Masa Specifike OL.5	Lejet e parashikuara të shkarkimit të ujërave të ndotura
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Për momentin nuk aplikohet
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Pajtueshmëria me Udhëzimin Administrativ MMPH - Nr.30/2014 për Kushtet, Mënyrat, Parametrat dhe Vlerat Kufizuese të Shkarkimit të Ujërave të Ndotura në Rrjetin e Kanalizimit Publik dhe në Trupin Ujor.
Masa Specifike OL.6	Posedimi i Licencës për shërbime
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Kompania posedon Licencën për shërbime të lëshuar nga ARRU
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Përtrirja e vazhdueshme e Licencës për shërbime dhe pajtueshmëria me të gjitha kushtet e saj
Shërbimi për Konsumatorë (SHK)	
Masa Specifike SHK.1	Zgjerimi i rrjetit të furnizimit me shërbime të ujësjellësit në të gjitha pjesët e zonës së shërbimit
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Mbulueshmëri prej 96% me shërbime të ujësjellësit, do të arrin deri në 100%, në fund të vitit 2019

Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Objektivi afatgjatë është mbulueshmëria prej 100% e zonës së shërbimit, aty ku është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur
Masa Specifike SHK.2	Zgjerim i rrjetit të grumbullimit të ujërave të ndotura (kanalizimit)
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Mbulueshmëri 100% në qendrat urbane dhe 50% në zonat rurale
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Objektivi afatgjatë është mbulueshmëria prej 100% të zonës së shërbimit, aty ku është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur
Masa Specifike SHK.3	Matja e ujit
Niveli i Shërbimit të tanishëm	90% e konsumatorëve me matje të ujit të harxhuar Kalibrimi i ujëmatësve sipas nevojës dhe kërkesës nga konsumatorët
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Të gjithë konsumatorët të kenë furnizim të matur me shërbimet e ujësjellësit Kalibrimi i të gjithë ujëmatësve brenda kohës standarde prej 5 viteve pas instalimit të tyre
Masa Specifike SHK.4	Komunikim efikas me konsumatorët për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Përmirësime graduale
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Përmirësime të dukshme
Çështjet teknike (T)	
Masa Specifike T.1	Menaxhimi i UPF (përfshirë humbjet komerciale dhe ato teknike)
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Trend gradual zvogëlues të UPF
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Reduktim në më pak se 36% të UPF
Masa Specifike T.2	Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Rregullimi i defekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Mirëmbajtja preventive (e planifikuar) e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit
Çështjet financiare (F)	
Masa Specifike F.1	Arritja e vetë-qëndrueshmërisë financiare
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Rritja graduale e të hyrave për të arritur vlerën e planifikuar
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Rritja e të hyrave deri në 100% të vlerës së planifikuar
Masa Specifike F.2	Rritja e vlerës së pasurive themelore
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Aftësi e kufizuar e mbulimit të investimeve të nevojshme

Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Rritja graduale e aftësisë financiare për mbulimin e investimeve të nevojshme
Çështjet menaxheriale (M)	
Masa Specifike M.1	Kërkimet dhe zhvillimet inovative
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Trend jo i kënaqshëm për shkak të aftësive të kufizuara financiare
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Përvetësim i trendeve zhvillimore inovative në të gjitha lëmitë e biznesit
Masa Specifike M.2	Sistemet elektronike të regjistrimit dhe përpunimit të të dhënave
Niveli i Shërbimit të tanishëm	Sistemet elektronike që mbulojnë kryesisht të dhënat financiare dhe deri diku ato gjeografike
Caku afatgjatë planifikues i Nivelit të Shërbimit	Zhvillimi i sistemeve elektronike të sofistikuara që mbulojnë të gjitha aspektet operative

4. Analiza e gjendjes ekzistuese të furnizimit me ujë dhe kanalizimit

4.1 Infrastruktura ekzistuese e furnizimit me ujë

Impianti i trajtimit të ujit (ITUP 1 & 2) në përgjithësi është në kushte të mira. Prodhimi mesatar është 1,800 m³/h ose 43,200 m³/d. Nga muaji Tetor 2018, ky kapacitet është dyfishuar dhe tani mundësia e prodhimit është: 3600 m³/h ose 86,400 m³/d. Gjatë viteve të ardhshme mund të garantohet një furnizim i qëndrueshëm me ujë gjatë 24 orëve për mbi 175,000 banorë në zonën e shërbimit.

Zona aktuale e shërbimit të KRU Radoniqi është përafërsisht 220 km² dhe përfshin Komunat e Gjakovës dhe fshatrat përreth, Rahovecit dhe fshatrat përreth dhe 15 fshatrat brenda kufirit administrativ të Komunës së Prizrenit, që është një pjesë e rëndësishme e Pellgut ujqor të "Drinit të Bardhë" i vendosur në Kosovë.

Mbulimi aktual me shërbim të furnizimit me ujë është 92.%. Janë gjithsej 35 stacione pompimi dhe 35 rezervuar në rrjetin e ujësjellësit.

Uji trajtohet duke përdorur teknologjitë e mëposhtme:

- Para-klorinimi,
- Koagulimi - flokulimin dhe sedimentim,
- Neutralizimi me gëlqere,
- Dozimin e karbonit aktiv,
- Filtrimin përmes rërës, dhe
- Dezinfektimi me klor të gazet në një rezervuar me një vëllim prej 2,100 m³.

Laboratori i KRU Gjakova, kryen analizat e mostrave të cilësisë së ujit çdo 2 orë. Zyra e IKSHP në Gjakovë teston çdo dy ditë dhe Instituti i Shëndetit Publik në Prishtinë i teston në intervale 6 mujore. Kompania aktualisht ofron shërbimet e furnizimit me ujë në komunat e Gjakovës, Rahovecit, dhe Prizrenit. Në një të ardhme të afërt Kompania do t'i ofrojë shërbimet e furnizimit me ujë edhe në komunat e Mamushës dhe Suharekës.

Burimet si dhe infrastruktura e furnizimit me ujë për komunat e zonës së shërbimit të Kompanisë janë dhënë në vijim.

4.1.1 Komuna e Gjakovës

Burimet e ujit

Komuna e Gjakovës furnizohet me ujë nga liqeni akumulues i Radoniqit me kapacitet 117 milion m³. Përpos Liqenit të Radoniqit, fshatrat e Komunës si : Damjani, Gerqina furnizohen nga burimet e ujit nentokesor në keto dy fshatra.

Në fund të vitit 2019, pritet të finalizohet edhe projekti i Rekes së Keqe, ku do shtohet edhe një burim i ri në bjeshkën e Babaj Bokës.

Figura 3: Foto nga Liqeni i Radoniqit



Impiantet e trajtimit të ujit

Impianti i trajtimit të ujit -faza I, e ka kapacitetin e projektuar prej 500 l/s. Impianti i trajtimit të ujit -faza II, e cila është lëshuar në funksion me 08.10.2018, ka kapacitetin e projektuar prej 500 l/s, ku tani gjithsejt kemi mundësi prodhimi 1000 l/sec. Gypsjellësi kryesor që transporton ujin nga impianti deri në rezervarin në Qerim 500+500 m³, polietilen GRPDN Ø 1100mm i gjatë 11 km, dhe pastaj vazhdon me gyp polietilen GRP DN Ø 800 mm, me gjatësi 3 km, deri te pika e zezë, ku bëhet shpërndarja në Gjakovë dhe Rahovec.

Figura 4: Foto nga Impiantet e trajtimit të ujit të pijes 1 & 2



Faza e dytë, me ç'rast janë punuar filtrat e ri dhe do të funksionon sistemi i kontrollit automatik SCADA.

Tabela 6: Burimet e ujit dhe kapacitetet e shfrytëzimit në komunën e Gjakovës

Burimet e ujit	Kapaciteti i prodhimit	Kapaciteti i shfrytëzuar (prodhimi)	
	(m ³ /vit)	(m ³ /vit)	(m ³ /ditë)
Liqeni i Radoniqit	31,536,000	17,300,000	47,397.26
Burimi Damjan	1,200,000	48,000	131,506
Burimi Gerqinë	800,000	31,200	85,479
Reka e Keqe (pritet 2019)	2,210,000	372,300	1,020.00
Prodhimi total:	35,746,000	17,751,500	265,402

Tabela 7: Rezervuaret dhe kapaciteti i furnizimit në Komunën e Gjakovës

Emërtimi	Vend-ndodhja	Komuna	Kapaciteti rezervues m ³
Rezervoari I në Çabrat	Çabrat	Gjakovë	200
Rezervoari II në Çabrat	Çabrat	Gjakovë	200
Rezervoari në Brekoc	Brekoc	Gjakovë	70
Rezervoari në Dol	Dol	Gjakovë	150
Rezervoari në Kusar II	Kusar	Gjakovë	150
Rezervoari I në Lipovec	Lipovec	Gjakovë	200
Rezervoari II në Lipovec	Lipovec	Gjakovë	200
Rezervoari I në Qerim	Qerim	Gjakovë	5,000
Rezervoari II në Qerim	Qerim	Gjakovë	5,000
Rezervoari në Cërmjan	Cërmjan	Gjakovë	150
Rezervoari në Damjan 1	Damjan	Gjakovë	150
Rezervoari në Damjan 3	Damjan	Gjakovë	200
Rezervoari në Shqiponjë	Shqiponjë	Gjakovë	500
Rezervoari në Palabardh	Palabardh	Gjakovë	400
Rezervoari në Gërquinë	Gërquinë	Gjakovë	400

Tabela 8: Stacionet e pompimit - Komuna e Gjakovës

Emri i stacionit të pompimit	Fuqia Instaluese (kW)	Nr. i pompave	Viti i instalimit	Gjendja aktuale
St pomp Çabrat	Q=10m³/h; P=11kw	2	2013	Shumë e mirë
St pomp Cërmajn		2	2004	
St pomp Brekoc	Q=10m³/h; P=11kw	2	2012	Shumë e mirë
St pomp Dol	Q=17m³/h; P=5.5kw	2	2009	Shumë e mirë
St pomp Lipovec	Q=30m³/h; P=18.5kw	2	2009	Shumë e mirë
St pomp Kusar I	Q=17m³/h; P=7.5kw	2	2009	Shumë e mirë
St pomp Zhdrellë	Q=108m³/h; P=90kw		1985	Mirë
St pomp Sopot	Q=108m³/h; P=22kw	2	1985	Mirë
SP Damjan1	Q=42m³/h; P=18.5kw	1	2002	Jo e mirë
SP Damjan3	Q=30m³/h; P=15kw	1	2002	Jo e mirë
SP Muhader	Q=2.5m³/h; P=2.5kw	1	2016	Shkëlqyeshëm
SP Fierzë	Q=2.5m³/h; P=2.5kw	1	2016	Shkëlqyeshëm
SP Novo Sellë	Q=2.5m³/h; P=2.5kw	1	2016	Shkëlqyeshëm
SP Rezinë	Q=2.5m³/h; P=2.5kw	1	2015	Shkëlqyeshëm
SP Shqiponjë	Q=134.6 m³/h; P=110kw	2	2016	Shkëlqyeshëm

4.1.2 Komuna e Rahovecit

Burimet e ujit

Komuna e Rahovecit, furnizohet me ujë nga liqeni akumulues i Radoniqit me kapacitet 117milion m³.

Përpos Liqenit të Radoniqit, fshatrat e Komunës së Rahovecit si : Hoqa e Madhe, Snoc, Drenoc dhe Oterush, furnizohen nga burimet e ujit nentokesor.

Dezinfektimi bëhet me klor të gaztë duke aplikuar paraklorimin dhe pasklorimin.

Tabela 9: Burimet e ujit dhe kapacitetet e shfrytëzimit në komunën e Rahovecit

Burimet e ujit	Kapaciteti i prodhimit	Kapaciteti i shfrytëzuar (prodhimi)	
	(m³/vit)	(m³/vit)	(m³/ditë)
Pus në Drenoc	90,000	21,600	59,178
Pusi në Senoc	70,000	30,000	82,191
Burimi në Hoçë të madhe	75,000	21,600	59,178
Burimi në Oterushë	90,000	27,600	75,616
Prodhimi total:	325,000	100,800	276,163

Tabela 10: Rezervuarët dhe kapaciteti i furnizimit në Komunën e Rahovecit

Emërtimi	Vend-ndodhja	Komuna	Kapaciteti rezervues, m3
Rezervoari në Rahovec I	Rahovec	Rahovec	1,500
Rezervoari në Rahovec II	Rahovec	Rahovec	2,500
Rezervoari në Pataqan I	Pataqan	Rahovec	180
Rezervoari në Pataqan II	Pataqan	Rahovec	120
Rezervoari në Pataqan II	Pataqan	Rahovec	105
Rezervoari në Vrajakë	Vrajakë	Rahovec	70
Rezervoari në Bratotin	Bratotin	Rahovec	50
Rezervoari në Rahovec III	Rahovec	Rahovec	250
Rezervoari në Rahovec IV	Rahovec	Rahovec	600
Rezervoari në Opterushë	Opterushë	Rahovec	315
Rezervoari në Drenoc	Drenoc	Rahovec	300
Rezervoari në Polluzhë	Polluzhë	Rahovec	400
Rezervoari në Senoc	Senoc	Rahovec	300
Rezervoari në Hoqë e Madhe	Hoqë e Madhe	Rahovec	200

Tabela 11: Stacionet e pompimit – Komuna Rahovec

Emri i stacionit të pompimit	Fuqia Instaluese (kW)	Nr. i pompave	Viti i instalimit	Gjendja aktuale
SP 'Rahovec'I	Q=252m³/h;P=132kw, Q=37m³/h;P=64kw	2+2	1985	Mirë
SP 'Rahovec'II	Q=64m³/h;P=37kw	2	1985	Jo e mirë
SP Pataqan	Q=37m³/h;P=18kw	2	2004	Mirë
SP Pataqan 1-2	Q=32m³/h;P=15kw	2	2004	Mirë
SP Vrajakë	Q=12m³/h;P=5.5kw	2	2006	Shumë e mirë
SP Bratotin	Q=1.5m³/h;P=1.5kw	2	2005	Mirë
SP Drenoc	Q=10m³/h;P=7.5kw	1	2006	Mirë
SP Senoc	Q=4.9m³/h;P=5.5kw	1	2006	Mirë
SP Opterushë	Q=30m³/h;P=22kw	1	2006	Mirë
Hoqë e Madhe	Q=5.0m³/h;P=7.5kw	1	2006	Mirë

4.1.3 Komuna e Prizrenit (fshatrat)

Burimet e ujit

Fshatrat e Komunës së Prizrenit, furnizohet me ujë nga liqeni akumulues i Radoniqit me kapacitet 117milion m³.

Tabela 12: Rezervuarët dhe kapaciteti i furnizimit në Komunën e Prizrenit

Emërtimi	Vend-ndodhja	Komuna	Kapaciteti rezervues m3
Rezervuari në Reti të ulët	Reti e Ulët	Prizren	106
Rezervuari i ri në Reti të ulët	Reti e Ulët	Prizren	150
Rezervuari në Dedaj	Dedaj	Prizren	67
Rezervuari në Zym	Zym	Prizren	600
Rezervuari në Bregdri	Zym	Prizren	250
Rezervuari në Kraj	Kraj	Prizren	260
Rezervuari ne Lubizhdë	Lubizhdë	Prizren	400

Tabela 13: Stacionet e pompimit në Komunën e Prizrenit

Emri i stacionit të pompimit	Fuqia Instaluese (kW)	Nr. i pompave	Viti i instalimit	Gjendja aktuale
SP Reti	Q=18m ³ /h; P=11kw	1	2002	Mirë
SP Dedaj	Q=22m ³ /h; P=7.5kw	1	2002	Jo e mirë
SP Breg Dri	Q=10m ³ /h; P=52kw	2	1995	Shumë e mirë
SP Karashingjergj	Q=2.5m ³ /h; P=2.5kw	1	2006	Shkëlqyeshëm
SP Kabash	Q=48m ³ /h; H= 120m P=22kw	2	2018	Shkëlqyeshëm

Tabela 14: Pasqyrë e gypsjellësve kryesorë të sistemit të furnizimit me ujë në KRU Gjakova

	Objekti-Emertimi	Materiali dhe ø	Gjatesia/m
1	Kulla Dige-Dalja tunelit	çelik ø 700	348.08
2	Dalja e tunelit-St. Filtrave	çelik ø 1100	634.23
3	St.Filtrimit-Rez. Qerim	GRP ø 1100	7772.2
4	Rez.Qerim-Gjakova I/rr. "Kalaja"	GRP ø 1100	1270
5	Gjakova I - Zona Industriale	GRP ø 800	313.33
		AC ø 800	1144.98
6	Zona industriale-rr."Gjergj Sokoli"	AC ø 400	473.7
7	Gjakova I-Gjakova II	GRP ø 800	994.26
8	Gjakova II -rr."V.Klark"/deri te rrethi/	AC ø700	1077.41
9	Rruga "UÇK" - Deri te Posta	AC ø 500	693.96
10	Posta rr." B.Qaushi"	AC ø 350	126.42

11	"Nene Tereza"	AC ø 250	444.57
12	Rr."Mark Malota"-Puseta e z.industriale	çelik ø 400	743.4
13	Rr."Gjergj Sokoli"/deri te mulliri/ deri te "Emin Duraku"	AC ø 150 AC ø 200	747.02 383.5
14	Rr."Deshmoret e Hereqit"/Dardane/	AC ø 200	793.54
15	Dardane-Osek Hile-Skivjan	AC ø 200	2734.14
16	Tranziti "Adem Jashari"	AC ø 500	608.05
17	Tranziti "Tirana"	AC ø 500	824.01
18	Tranziti - Tirana _Rethi te PB."Bakija"	PE ø 500	132.48
19	Nga Posta-Puseta ne rr."I.Qemajli"	AC ø 350	110.4
20	Nga puseta rr."N.Tereza-Qarshia e Vogel	PE ø 315	823.37
21	Rr. "Skenderbeu" deri	PE ø 250 AC ø 150 AC ø 300	151.13 397.22 315.6
	Rethi te PB."Bakija"	PE ø 315	84.34
22	Rr."Ismail Qemajli" /puseta/	AC ø 350 AC ø 350	242.9 28.14
23	Rr." S.Hadum Aga"	PE ø 315	382.6
24	Rr."Izet Hima"/deri te rrethi M.Jusufi/	PE ø 315 AC ø 350	293.69 57.4
25	Rr."Gjon Nikoll Kazazi"-te ura e Tabakeve	AC ø 250	532.59
	Ura e Tabakeve/re/	çelik ø 200	166.09
26	Brekoc,rr."Domenik Pergegaj"	AC ø 200	280.34
	Brekoc,rr."Saranda"	AC ø 150	475.25
27	Rruga Bujar Roka	PE ø 200 PE ø 160	540.52 197.13
28	Gjakova II via Xerxe/UraTerezive/	GRP ø 800	7061.06
29	Ura Terezive	çelik ø 800	200.31
30	Ura -Terezive -Kalimi i Drinit	GRP ø 800	3064.1
31	Kalimi Drinit	çelik ø 800	240.35
32	Kalimi Drinit - Puseta Xerxe	GRP ø 800	1944.12
33	Xërxë - Rez. Rahovec I	GRP ø 800 AC ø 600	573.33 7218.28
34	Rez.Rahoveci I SP Rahovec II	çelik ø 400	2203.67
35	Rez.Rahoveci I- Rahovec II	PE ø 225	2365.43
36	SP Rez.II - Rez.III / i vjetri/	çelik ø 200	764.31
37	SP Rez.II - Rez.III / i riu/	PE ø 200	869.68
38	Gypi te SP II	AC ø 200	14.41
39	Rez.III - Rr."Deshmoret e Demokracise"	AC ø 200	548.45
40	Rez. III i vjeter - Rez.III i riu	PE ø 200	158.79

41	Rez. III Hoqa Madhe	PE ø 110	3528.51
42	Ndarja Fortese	AC ø 400	1600.37
	deri Celine	AC ø 350	4306.03
43	Celine - Krusha Madhe	AC ø 350	2025.46
44	Krusha e vogel	AC ø 250	584.93
45	Pirane	AC ø 250	1786.2
		AC ø 150	294.74
46	Pirane - Reti	AC ø 150	4752.77
47	Zhdrelle rr."Muse Musa"	AC ø 350	2742.94
48	Zhdrelle - Therrtorja e Becit	AC ø 350	1036.97
49	Therrtorja e Becit - Doblibare	AC ø 250	3676.5
50	Xerxe - Gexhe	AC ø 300	3217.75
51	Gexhe - Malesi e vogel/Radost/	AC ø 300	888.69
52	Malesi e Vogel - Ratkovc	AC ø 250	3257.33
53	Krusha Vogel - Bregdri	AC ø 250	1810.67
54	Bregdri - Zym	AC ø 250	682.77
		AC ø 200	1996.25
55	Zym - Karashingjergj	PE ø 160	1691.99
56	Bregdri - Krajk	PE ø 160	2242.35
57	Fshaj - Rogove	AC ø 300	5737.22
58	Sopot - Palabardh	AC ø 200	1762.54
59	Palabardh - Novoselle	AC ø 150	1287.6
60	Stacioni Filtrimi -Thertorja-Vraniq	PE ø 350	120.17
		PE ø250	2584.51
		PE ø 350	2623.76
61	Vraniq-Meqë	PE ø 110	3784.81
			114,588.11

Figura 5: Sistemi i gypsjellësve kryesor të KRU Gjakova



4.2 Infrastruktura ekzistuese e kanalizimit

Shërbimi aktual ofron shërbime të kanalizimit rreth 50% të popullsisë (zona e përgjithshme e furnizimit). Rreth 86,000 banorë janë të lidhur me sistemet e kanalizimeve urbane në Gjakovë dhe Rahovec. Ujërat e ndotura nga Gjakova dhe Rahoveci rrjedhin pa u trajtuar në rrjedhat ujore përreth. Për qytetin e Gjakovës, është kuptuar se shkalla e kyçjes në sistemin e kanalizimeve është në masën 85%.

Gjatësia totale e sistemit ekzistues të kanalizimeve në Gjakovë është rreth 56 km. Diametrat e gypave janë midis DN 200 dhe DN 600, dhe materiali kryesor i gypave është *azbest çimentoja* (> 80 %, kryesisht diametrat më të vegjël). Material tjetër i gypave është qeramika dhe gypat e plastikës. Mosha mesatare e rrjetit është rreth 40 vjet.

Gjendja e kanalizimeve ekzistuese është e dobët dhe besohet se ndodhin rrjedhje të mëdha. Njohuria e sistemit të kanalizimeve në të kaluarën kryesisht u mbajt nga operatorët e sistemit shumica e të cilëve nuk janë më në dispozicion për të ndihmuar me detajet e vendndodhjes së sistemit apo funksionimit të tij. Prandaj, informacioni është jo i plotë dhe duhet bërë shumë punë për të rimarrë atë njohuri.

Sistemi i kolektorëve lokal sekondar dhe kyçjeve të konsumatorëve nuk është planifikuar të rehabilitohet ose zëvendësohet në asnjë prej nismave të financuara nga donatorët aktualisht. Është planifikuar vetëm rehabilitimi dhe zëvendësimi i kolektorëve kryesor të ujërave sanitare I dhe II.

Ekziston edhe një detyrë që është shkyçja e kyçjeve të kanalizimit sanitar në atë atmosferik por që kjo do të jetë punë e rastësishme dhe jo pjesë e një iniciative më të madhe. Prandaj KRU Gjakova, duhet të marrë iniciativën dhe të fillojë një program të riparimit ose renovimit të kolektorëve sekondar aty ku kjo është e nevojshme.

4.3 Trajtimi i ujërave të ndotura


Në rajonin e Gjakovës (komunat e zonës së shërbimit të Kompanisë) nuk ka asnjë impiant të trajtimit të ujërave të ndotura. Ujërat e ndotura të kanalizimit, të patrajuara, shkarkohen direkt në lumin Erenik dhe Krena, Llukaf, në qytetin e Gjakovës.

Në muajin Shtator ka filluar ndërimi i dy kolektoreve kryesor, dhe gjithashtu është nënshkruar kontrata për ndërtimin e Impiantit të ujërave të ndotura.

Tabela 15: Përmbledhje e investimeve të planifikuara në rrjetin e kanalizimit në komunën e Gjakovës

Investimet e planifikuara	Kostoja e vlerësuar (EUR)
Ndërimi i kolektorëve kryesor 1 dhe 2	5,545,933.26
Ndërtimi i Impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura	7,271,112.00
Kostoja totale investimeve në rrjetin e kanalizimit 2018-2021	12,817,045.26

Figura 6: Rrjeti ekzistues i kanalizimit në Gjakovë



Përfituesi kryesor i projektit është ndërmarrja rajonale e ujit dhe kanalizimit, KRU Radoniqi, e cila në të njëjtën kohë vepron si Agjencia për Ekzekutimin e Projektit (PEA). Shërbimet e konsulencës kryhen nga asociacioni IGIP/Sachsen Wasser/Hidroing DK. Derisa shërbimet e Konsulencës së Implementimit kryhen nga IGIP dhe Hidroing, Shërbimet e Konsulencës për **Masat Shoqëruese (AM)** ndërmerren nga Sachsen Wasser GmbH, në partneritet me nënkonsulentin vendor Hidroing-DK.

5. Analiza e kërkesës për ujë

5.1 Bilanci i kërkesës dhe kapaciteteve të furnizimit

5.1.1 Shtimi i popullsisë

Meqenëse ASK nuk e ka bërë parashikimin e rritjes së popullsisë sipas komunave por vetëm në nivel të vendit, shtimi i parashikuar i popullsisë për komunat e zonës së shërbimit të KRU Gjakova është kalkuluar duke marrë për bazë trendin e njëjtë të rritjes së parashikuar nga ASK për Kosovë.

Bazuar në këtë kalkulim, është vlerësuar se gjatë periudhës 10 vjeçare (deri në vitin 2028) popullsia në zonën e shërbimit të Kompanisë do të këtë një shtim relativisht të vogël prej rreth 4,000 banorë në total krahasuar me popullsinë aktuale. Kjo rritje e popullsisë është kalkuluar për 3 komunat që janë të integruara në zonën e shërbimit.

ASK parasheh që trendi i popullsisë do të jetë në rritje deri në vitin 2027, ndërsa prej vitit 2028, trendi do të jetë në rënie.

5.1.2 Kërkesa për ujë

Në anën tjetër, kërkesa për ujë (shih Shtojcën 3.c) gjatë periudhës planifikuese nuk të rritet si rezultat i shtimit të popullsisë, si dhe nuk pritet të rritet edhe për mbulueshmëri sepse që në këtë moment përqindja e mbulueshmërisë është 92%

Për përllogaritjen e kërkesës për ujë janë bërë supozimet si vijon:

- 1) Është parashikuar **ngritja e shkallës së mbulimit me shërbime të ujësjellësit prej 92% (160.667 banorë) sa është aktualisht në 100% në vitin 2022 (172,372 banorë)**,
- 2) Është parashikuar **zvogëlimi i shkallës së ujit të pafaturuar (UPF) prej 44% sa është aktualisht në 36% për vitin 2028**;
- 3) Është parashikuar **rritja graduale e normës së konsumit të ujit nga 110 litra/ditë/banor (sa faturohet aktualisht) në 130 litra/ditë/banor në vitin 2028**. Kjo rritje e normës së konsumit pritet të ndodhë si rezultat i zvogëlimit të humbjeve komerciale të ujit (vjedhja e ujit, pasaktësitë e matjes dhe faturimit etj.).

Alternativisht, kërkesa për ujë do të mund të vlerësohej edhe duke marrë (i) normën e konsumit prej 155 litra/ditë/banor dhe duke ia shtuar asaj (ii) sasinë e ujit të faturuar për konsumatorët komercial dhe institucional (14%) si dhe (iii) sasinë e humbjeve fizike të ujit (rreth 25%) të zvogëluar sipas planifikimit të Kompanisë për zvogëlimin e humbjeve të ujit.

Tabela 16: Parashikimi i shtimit të popullsisë (mijë banorë) dhe kërkesa për ujë

Shtojca 3.1: Kërkesa për Ujë													
		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
1	Projekcionet demografike (banorë)												
	KRU Gjakova	172,369	173,075	173,712	174,319	174,601	175,358	175,736	176,004	176,221	175,353	176,380	176,372
	Gjakova	151,041	151,661	152,216	152,743	152,947	153,632	153,944	154,153	154,314	153,395	154,378	154,327
	Reka e keqe	10,251	10,292	10,333	10,374	10,416	10,457	10,499	10,541	10,583	10,625	10,668	10,711
	Damjan	5,315	5,337	5,357	5,375	5,392	5,407	5,419	5,427	5,434	5,438	5,439	5,439
	Gërquinë	1,300	1,305	1,310	1,314	1,318	1,322	1,325	1,327	1,329	1,330	1,330	1,330
	Drenoc	1,643	1,650	1,656	1,662	1,667	1,672	1,675	1,678	1,680	1,681	1,682	1,681
	Senoc	711	714	717	719	722	724	725	726	727	728	728	728
	Hoçë e Madhe	128	129	129	130	130	131	131	131	131	131	131	131
	Opterushë	1,979	1,987	1,994	2,001	2,008	2,013	2,017	2,021	2,023	2,025	2,025	2,025
2a	Mbulueshmëria me shërbime (banorë)												
	KRU Gjakova	160,118	160,624	172,291	172,824	174,338	175,211	175,736	176,004	176,221	175,353	176,380	176,372
	Gjakova	149,041	149,502	151,125	151,502	152,850	153,632	153,944	154,153	154,314	153,395	154,378	154,327
	Reka e keqe			10,003	10,120	10,250	10,310	10,499	10,541	10,583	10,625	10,668	10,711
	Damjan	5,315	5,337	5,357	5,375	5,392	5,407	5,419	5,427	5,434	5,438	5,439	5,439
	Gërquinë	1,300	1,305	1,310	1,314	1,318	1,322	1,325	1,327	1,329	1,330	1,330	1,330
	Dreno	1,643	1,650	1,656	1,662	1,667	1,672	1,675	1,678	1,680	1,681	1,682	1,681
	Senoc	711	714	717	719	722	724	725	726	727	728	728	728
	Hoçë e Madhe	128	129	129	130	130	131	131	131	131	131	131	131
	Opterushë	1,979	1,987	1,994	2,001	2,008	2,013	2,017	2,021	2,023	2,025	2,025	2,025
2b	Mbulueshmëria me shërbime (%)												
	KRU Gjakova	92.89	92.81	99.18	99.14	99.85	99.92	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
	Gjakova	98.68	98.58	99.28	99.19	99.94	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
	Reka e keqe	-	-	96.81	97.55	98.41	98.59	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
	Damjan	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
	Gërquinë	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
	Drenoc	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
	Senoc	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
	Hoçë e Madhe	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
	Opterushë	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00

Tabela 17: Kërkesa e përgjithshme për ujë për periudhën planifikuese

		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
3.1a	Kërkesa për ujë: konsumatorët shtëpiak (m3/ditë)												
	<i>Norma e konsumit</i>	94	98	102	105	108	110	112	114	116	118	120	120
	KRU Gjakova	15,051	15,741	17,574	18,147	18,828	19,273	19,682	20,064	20,442	20,692	21,166	21,165
	Gjakova	14,010	14,651	15,415	15,908	16,508	16,900	17,242	17,573	17,900	18,101	18,525	18,519
	Reka e keqe	-	-	1,020	1,063	1,107	1,134	1,176	1,202	1,228	1,254	1,280	1,285
	Damjan	500	523	546	564	582	595	607	619	630	642	653	653
	Gërquinë	122	128	134	138	142	145	148	151	154	157	160	160
	DrenoD	154	162	169	175	180	184	188	191	195	198	202	202
	SenoD	67	70	73	76	78	80	81	83	84	86	87	87
	Hoçë e Madhe	12	13	13	14	14	14	15	15	15	16	16	16
	Opterushë	186	195	203	210	217	221	226	230	235	239	243	243
3.1b	Kërkesa për ujë: konsumatorët jo shtëpiak (m3/ditë)												
	KRU Gjakova	3,678	3,693	3,707	3,720	3,732	3,742	3,750	3,756	3,760	3,763	3,764	3,763
	Gjakova	3,424	3,437	3,252	3,261	3,272	3,281	3,285	3,290	3,293	3,292	3,294	3,293
	Reka e keqe	0	0	3,252	3,317	3,383	3,451	3,520	3,590	3,662	3,735	3,810	3,886
	Damjan	122	125	127	130	132	135	137	140	143	146	149	152
	Gërquinë	30	30	31	32	32	33	34	34	35	36	36	37
	DrenoD	38	38	39	39	40	41	42	43	44	44	45	46
	SenoD	16	33	33	34	35	35	36	37	38	38	39	40
	Hoçë e Madhe	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	4	4
	Opterushë	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	57
3.1	Kërkesa për ujë: shtëpiak + joshtëpiak												
	m3/ditë	18,729	19,434	21,281	21,867	22,560	23,015	23,432	23,820	24,202	24,455	24,930	24,928
	l/s	117.0	121.0	123.5	126.5	129.4	131.4	133.3	135.3	137.3	139.5	141.3	141.3
	Gjakova	17,433	18,088	18,666	19,169	19,780	20,181	20,527	20,863	21,193	21,392	21,820	21,812
	Reka e keqe	-	-	4,272	4,379	4,490	4,585	4,696	4,792	4,889	4,989	5,090	5,171
	Damjan	622	648	673	694	715	730	744	759	773	788	801	804
	Gërquinë	152	158	165	170	175	178	182	186	189	193	196	197
	DrenoD	192	200	208	214	220	225	230	234	238	243	247	248
	SenoD	83	103	107	110	113	115	117	120	122	124	126	127
	Hoçë e Madhe	15	16	16	17	17	18	18	18	19	19	19	19
	Opterushë	231	241	251	258	266	272	277	283	288	293	298	299

		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
3.2	Uji i Pafaturuar (m3/ditë)												
	Shkalla e planifikuar e UPF	44%	43%	42%	42%	41%	41%	40%	39%	39%	38%	37%	36%
	KRU Gjakova	14,716	14,661	15,410	15,834	15,678	15,994	15,622	15,229	15,473	14,988	14,641	14,022
	Gjakova	13,698	13,646	13,517	13,881	13,745	14,024	13,684	13,339	13,550	13,111	12,815	12,269
	Reka e keqe	-	-	3,093	3,171	3,120	3,186	3,130	3,064	3,126	3,058	2,989	2,909
	Damjan	488	489	488	503	497	507	496	485	494	483	471	453
	Gërquinë	119	119	119	123	121	124	121	119	121	118	115	111
	DrenoD	151	151	150	155	153	156	153	150	152	149	145	140
	SenoD	65	77	77	79	78	80	78	77	78	76	74	72
	Hoçë e Madhe	12	12	12	12	12	12	12	12	12	12	11	11
	Opterushë	182	182	182	187	185	189	185	181	184	180	175	168
	Koef. i UPF (1-%)	0.79	0.75	0.72	0.72	0.69	0.69	0.67	0.64	0.64	0.61	0.59	0.56

3.3	Kërkesa totale për ujë (=kërkesa për ujë + UPF)												
	KRU Gjakova (m3/d)	33,445	34,267	42,140	43,270	43,840	44,737	44,811	44,841	45,595	45,396	45,566	44,982
	Gjakova (m3/ditë)	31,131	31,734	32,183	33,050	33,525	34,205	34,211	34,202	34,743	34,504	34,635	34,081
	(milion m3/vit)	11.36	11.58	11.75	12.06	12.24	12.48	12.49	12.48	12.68	12.59	12.64	12.44
	Reka e keqe (m3/ditë)	-	-	7,365	7,550	7,610	7,771	7,826	7,855	8,015	8,046	8,079	8,080
	(m3/vit)	-	-	2.69	2.76	2.78	2.84	2.86	2.87	2.93	2.94	2.95	2.95
	Damjan (m3/ditë)	1,110	1,136	1,161	1,197	1,211	1,237	1,241	1,244	1,268	1,270	1,272	1,257
	(milion m3/vit)	0.41	0.41	0.42	0.44	0.44	0.45	0.45	0.45	0.46	0.46	0.46	0.46
	Gërquinë (m3/ditë)	271	278	284	293	296	302	303	304	310	311	311	307
	(milion m3/vit)	99,077	0.101	0.104	0.107	0.108	0.110	0.111	0.111	0.113	0.113	0.114	0.112
	DrenoD (m3/ditë)	343	350	358	369	373	381	383	384	391	392	392	388
	(milion m3/vit)	0.125	0.128	0.131	0.135	0.136	0.139	0.140	0.140	0.143	0.143	0.143	0.141
	SenoD (m3/ditë)	149	319	328	338	344	352	355	359	366	369	373	371
	(milion m3/vit)	0.05	0.116	0.120	0.123	0.126	0.128	0.130	0.131	0.134	0.135	0.136	0.135
	Hoqë e madhe(m3/ditë)	27	27	28	29	29	30	30	30	31	31	31	30
	(milion m3/vit)	0.01	0.010	0.010	0.011	0.011	0.011	0.011	0.011	0.011	0.011	0.011	0.011
	Opterushëm3/ditë)	413	423	432	445	451	460	462	463	472	473	474	468
	(milion m3/vit)	0.15	0.154	0.158	0.163	0.165	0.168	0.169	0.169	0.172	0.173	0.173	0.171
3.0	KËRKESA TOTALE PËR UJË												
	(m3/ditë)	33,445	34,267	42,140	43,270	43,840	44,737	44,811	44,841	45,595	45,396	45,566	44,982
	(l/s)	387	397	488	501	507	518	519	519	528	525	527	521
	(milion m3/vit)	12.207	12.508	15.381	15.794	16.002	16.329	16.356	16.367	16.642	16.569	16.632	16.419

Siç shihet nga tabela 17 më sipër, kërkesa totale për ujë për vitin 2028, është përlogaritur të jetë mbi **16.419 milion m³**, ose mesatarisht **521 l/s**.

5.1.3 Kapaciteti i furnizimit

Kapaciteti i furnizimit të KRU Gjakova, është kalkuluar sipas komunave të cilat janë në zonën e shërbimit të Kompanisë dhe duke u bazuar në kapacitetet aktuale të cilat Kompania i ka në dispozicion/shfrytëzim.

Tabela 18: Kapacitetet e furnizimit të KRU Gjakova

SHTOJCA 3.2: Kapaciteti i Trajtimit													
		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
1 KRU Gjakova (m3/vit)													
1.1	Liçeni I Radoniqit	31,536,000	31,536,000	31,536,000	31,536,000	31,536,000	31,536,000	31,536,000	31,536,000	31,536,000	31,536,000	31,536,000	31,536,000
1.2	Burimi I Rekes së Keqe			2,210,000	2,210,000	2,210,000	2,210,000	2,210,000	2,210,000	2,210,000	2,210,000	2,210,000	2,210,000
1.3	Burimi në Damjan	1,200,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000
1.5	Burimi në Gërqinë	800,000	800,000	800,000	800,000	800,000	800,000	800,000	800,000	800,000	800,000	800,000	800,000
1.6	Burimi në Drenoc	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000
1.7	Burimi në Senoc	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000
1.8	Pusi në Hoçë e Madhe	75,000	75,000	75,000	75,000	75,000	75,000	75,000	75,000	75,000	75,000	75,000	75,000
1.9	Pusi në Opterushë	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000	90,000
	Total Gjakova:	33,861,000	33,861,000	36,071,000	36,071,000	36,071,000	36,071,000	36,071,000	36,071,000	36,071,000	36,071,000	36,071,000	36,071,000
Total Kapaciteti i furnizimit (trajtimit)													
